

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakti nga procesverbali, e dymbëdhjetë - XII, të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 26.11.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete.

Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Fidan Berisha, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Doruntina Jashari, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Besnik Osmani - Nënkryetar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Ardit Sekiraqa - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Parayll Zogjani - Drejtor i Planifikimit Urban dhe Vjosa Kida Hyseni - Drejtores e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Të Tjerë: Rrahim Tërnavë - Kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës në Fushë-Kosovë. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 26.09.2024, 14.10.2024 dhe 23.10.2024.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.
4. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.
5. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026.
6. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e mësimi jo formal.
7. Propozim për formimin e Komisioneve për zgjedhjen e Krijuesit dhe Sportistëve për vitin 2024.
8. Propozim për ndryshimin e vendimit Nr. 93, të datës 31.03.2022 për anëtarët e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

9. Propozim për rishqyrtimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 120, të datës 03.10.2024 sipas shkresës 020-619/2 të datës 21.10.2024, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Fushë-Kosovë.
10. Rishqyrtimi i vendimit Nr. 94, të datës 08.07.2024, sipas shkresës 020-464/4 të datës 08.08.2024, për lejimin e mjeteve financiare dhe hapjen e procedurave për norma - vende të reja të punës në arsim.
11. Informatë e Drejtorisë së Planifikimit Urban lidhur me Projekt-Planin Zhvillimor Komunal.
12. Propozim për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në Institucionet Edukative Arsimore.
13. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme, të nderuar kolegë, sot më ka ardhur një kërkesë, për një pikë shtesë të rendit të ditës, nga Drejtoria e Arsimit ku thotë, duke u bazuar në shpalljen e konkurseve për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve sipas Udhëzimit Administrativ, me Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues para universitar në Republikën e Kosovës, kërkoj që të lejohet formimin i dy komisioneve shtesë për rekrutimin e dy zëvendës drejtorëve në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' dhe Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' Aneksi 1, sa i përket pikës shtesë, kishte qenë mirë, me dal Drejtori i Arsimit dhe me na dhënë sqarime, sepse me siguri është urgjencë dhe për këtë arsye e ka dërguar në shqyrtim, sepse Sekretaria e Kuvendit ju ka kërkuar dy herë që kush do që ka pika për mbledhjen e Kuvendit t'i sjell me kohë deri me datën 15.11.2024. Hap debatin për pikën shtesë të rendit të ditës.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë, meqenëse Drejtori i Arsimit, nuk është sot prezent në mbledhjen e Kuvendit, u ndjeva i obliguar me dalë dhe me sqaruar këtë pikë shtesë të rendit të ditës, realisht kjo pikë e rendit të ditës, është dashur të plotësohet atëherë kur kanë qenë komisionet, mirëpo për shkak të një lëshimi teknik të kolegëve në administratë, na duhet që sot t'i formojmë këto dy komisione për dy zëvendës drejtor, meqenëse janë procedura që duhet të vazhdohen, nëse kemi mirëkuptimin e juaj që ta qesim tek pika e fundit dhe ta plotësojmë vendimin e datës 30.05.2024, do të ishte një ndihmë e madhe për punën e administratës, nëse nuk e votoni këtë mbledhje, mbetet në mbledhjen e radhës, të vijë si pikë e rregullt në Kuvendin e Komunës.

Hasan Ismajli: Përshëndetje për të gjithë, po ashtu për Kryetarin e Degës së Partisë Demokratike të Kosovë dhe Sekretarin e Degës së Lëvizjes Vetëvendosje. Unë para dy mbledhje kam propozuar, që të jetë pikë e rendit të ditës 'Lirimi i Hapësirve Publike të Uzurpuara', sidomos në 'Lagjen Dardania', kërkoj nga ju Kryesues i Kuvendit të Komunës që ta qitni në votim dhe të ju dalim në ndihmë banorëve të cilët janë shumë të shqetësuar nga këto uzurpime, të cilat disa janë të lëshuara me leje të përkohshme dhe disa nuk kanë fare leje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë dua ta di qëndrimin e Shefave të Grupeve Parlamentare, për pikat shtesë të cilat u propozuan, pastaj i hedhim në votim.

Durim Hajra: Përshëndetje për të gjithë, sa i përket pikave shtesë të rendit të ditës, i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, kjo praktikë prap po ri përsëritet, unë dua ta di për ju Kryesues a'keni komunikim me Drejtorët e Drejtorive, sepse duhet me ditë edhe Drejtori, se në qoftë se keni

një shkollë të re, duhet me qenë edhe drejtori, edhe zëvendësdrejtori, me pas stafin, po ashtu drejtori nëse këtë pikë e ka pasur urgjente, të paktën u deshtë me kanë sot para nesh. Unë mendoj se urgjenca bjen, le të vjen në mbledhjen e ardhshme edhe e përgatitë më mirë. Ndërsa sa i përket propozimit të kolegut z. Hasan Ismajli, tani Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, e ka mbështetë dhe do ta mbështesim, sepse hapësirat publike janë të uzurpuara sidomos në ‘Lagjen Dardania’.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për të gjithë, po ashtu për Kryetarin e Degës së Partisë Demokratike të Kosovë për vizitën. Unë nuk dua të zgjas shumë sepse ato që u deshtë me i thënë, i tha kolegu Durim Hajra, sepse edhe ligji thotë, se sa i përket pikave shtesë të rendit të ditës, duhet të kenë urgjencë me interes publik. Kjo është mos punë e Drejtorisë së Arsimit dhe këtë ne nuk e mbështesim, ndërsa sa i përket propozimit të kolegut z. Hasan Ismajli, keni shumë të drejtë, unë kisha ftuar qoftë Kryetarin e Komunës apo Nënkryetarin e Komunës, me dalë tek rruga ‘Shefki Kulteta’ dhe me shikur kur fëmijët janë duke shkuar në shkollë, se si është gjendja e hapësirave publike, sepse aty janë duke u rrezikuar fëmijët.

Hasan Ismajli: Unë pajtohem plotësisht me kolegun z. Mirsad Qyqalla, sepse pika e Drejtorisë së Arsimit, është mos punë e kësaj drejtorie, ju Kryesues i Kuvendit të Komunës, e lexuat mirëpo unë nuk kam material dhe nuk e di çka me votuar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Dua të përgjigjem në pyetjen e asambleistit, z. Durim Hajra, po unë kam komunikim me të gjithë Drejtorët e Drejtorive dhe çdo muaj ju dërgojmë nga një e-mail të gjithë Drejtorëve të Drejtorive, këtë muaj ua kemi dërguar dy e-maila, që kush ka pika të rendit të ditës t’i sjell me kohë, sepse afati është deri me 15.11.2024, sa i përket pikës shtesë së Drejtorisë së Arsimit, drejtori ka ardhur personalisht dhe më ka takuar, unë i kam premtuar Drejtorit të Arsimit, që unë do ta sjellë në Kuvend, ta qesim në votim dhe pastaj vendos Kuvendi, sepse unë kam vetëm një votë.

Tani unë e qes në votim pikën shtesë të Drejtorisë së Arsimit ‘Kërkesë për plotësimin e vendimit me Nr. 88 të datës 25.06.2024 për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në Institucionet Edukative Arsimore’.

U votua me: katërbëdhjetë vota ‘për’, katër vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, nga gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se ‘Kërkesë për plotësimin e vendimit me Nr. 88 të datës 25.06.2024 për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në Institucionet Edukative Arsimore’, hyn për shqyrtim si pikë shtesë e rendit të ditës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim pikën e dytë shtesë, ‘Kërkesën për lirim e hapësirave publike të uzurpuara në qytetin e Fushë-Kosovës’.

U votua me: dymbëdhjetë vota ‘për’, asnjë votë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej dymbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se pika shtesë e asambleistit z. Hasan Ismajli ‘Kërkesën për lirim e hapësirave publike të uzurpuara në qytetin e Fushë-Kosovës’, në mungesë të votave nuk hyn si pikë e rendit të ditës për shqyrtim.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës në tërësinë e tij, me pikën shtesë të aprovuar ‘Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit me Nr. 88 të datës 25.06.2024 për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në Institucionet Edukative Arsimore’.

U votua me: katërmbëdhjetë vota 'për', katër kundër 'kundër', gjithsej tetëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme me pikën shtesë 'Kërkesën për plotësimin e vendimit me Nr. 88 të datës 25.06.2024 për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në Institucionet Edukative Arsimore'.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 26.09.2024, 14.10.2024 dhe 23.10.2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani i kemi për shqyrtim dhe aprovim tri ekstrakte të procesverbaleve, nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 26.09.2024, 14.10.2024 dhe 23.10.2024, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet e e juaja.

Durim Hajra: Lidhur me ekstraktet e procesverbaleve dihet qëndrimi ynë për mos votimin e tyre, për arsye të mos publikimit të audio-incizimeve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, por tani edhe ju duhet të veproni i nderuari Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, si bartës i organit legjislativ.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë i kam marrë veprimet e mija administrative përmes shkresave zyrtare edhe për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, edhe Ekzekutivin e Komunës, por edhe një herë ju bëjë thirrje përgjegjësve që kjo punë të rregullohet, sepse është kërkesë e të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës.

Mirsad Qyqalla: Tani unë dua ta dijë deri ku ka shkuar procesi për publikim dhe cili është problemi, ku keni ngecur dhe kjo është arsyeja, pse ne nuk i votojmë ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i qiti në votim për aprovim 'Ekstraktet e Procesverbaleve, nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më datën: 26.09.2024, 14.10.2024 dhe 23.10.2024'.

U votua me: katërmbëdhjetë vota 'për', dhjetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Ekstraktet e Procesverbaleve, nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më datën: 26.09.2024, 14.10.2024 dhe 23.10.2024'.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për ju, i nderuar Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës. Faleminderit që ke gjetur kohë që të vishë dhe të na vizitosh, po ashtu përshëndesim edhe Sekretarin e Lëvizjes Vetëvendosje i cili ishte prezent. Po ashtu uroj kandidaturën për deputet të Republikës së Kosovës, znj. Mirlinda Krasniqi dhe z. Laureat Gojnovci, shëndet dhe suksese.

Ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrajnë pyetje në qoftë se kanë.

Durim Hajra: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë desha të parashtraj pyetje për Drejtorin e Arsimit, mirëpo nuk qenka këtu, por me qenë se Nënkryetari i Komunës doli më herët në emër të Drejtorisë së Arsimit, besoj se do marrim përgjigje. I nderuar Nënkryetar, në disa Institucione Edukativo-Arsimore, ka mungesë të lëndëve djegëse - drunjtëve, cilat janë veprimet të cilat i keni ndërmarrë, sa i përket sigurimit të lëndëve djegëse për Institucione Edukativo-Arsimore dhe një nën pyetje, a keni parë një thirrje publike, që është bërë prej Korporatës Energjetike të Kosovës, me bërë kërkesë për furnizim me thëngjill për institucionet publike, pse

Komuna e Fushë Kosovës, nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi, sepse pikërisht këtë vite, është duke u ballafaquar me këtë problem. Pyetjen tjetër e kam, sa mësimdhënës janë mungesë në Institucionet Arsimore, kryesisht në ciklin e fillor dhe të mesëm, unë në Komitetit e Arsimit, e theksova që në shkollën teknike, prej fillimit të gjysëm vjetorit, mungon mësimdhënësi i lëndës së Bazave të Elektros dhe mësimdhënësi i lëndës së Ekonomisë. Nëse në një shkollë të mesme për një gjysmë vjetor, mungojnë dy mësimdhënës, atëherë më tregoni, se si këta nxënës mundën me kaluar gjysëm vjetorin. Kam pyetje edhe për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, ku nuk mundem me vendos si pikë shtesë të rendit të ditës, po ashtu drejtori nuk merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Nuk e di ju Nënkyetar i Komunës, a'keni kompetencë dhe vullnet me u merrë me këtë drejtori, sepse 'Lagjja Dardania' me të vërtetë është shqetësuese për qytetarët, për arsye të uzurpimit të hapësirave publike, nëse drejtori nuk ndërmer asgjë, atëherë ne në çdo pikë të rendit të ditës tek 'Pyetje dhe Përgjigjet', do të parashtrijmë pyetje për uzurpimin e hapësirave publike. Ne na keni premtuar, në bisedat private te cilat i kemi pasur, që do të ndërmermi shumë shpejt diçka, në lidhje me këtë çështje. Po ashtu, dua të parashtrij pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, tek fillimi i rrugës 'Rexhep Mala' ku çdo herë kur ka reshje ajo rrugë, bëhet e pakalueshme, për makinat dhe për këmbësorë, sepse mungon rrjeti i kanalizimit fekal dhe kanalizimit atmosferik, unë e kam adresuar edhe më herët këtë çështje, mirëpo ju nuk keni ndërmarrë asgjë.

Mirsad Qyqalla: Faleminderit Kryesues, unë çdo herë e respektoj kohën e minutazhës, unë deshta disa përgjigje, nga Drejtoria e Arsimit, mirëpo drejtori nuk qenka prezent, unë po i parashtrij që të mbesin në procesverbal, në disa shkolla na u është thënë që kabinetet janë përfunduar, mirëpo unë e pata një shqetësim nga prindërit për shkollën fillore 'Mihal Grameno' - Aneksi 2', ku thonë se kabinetet janë pa pajisje të nevojshme dhe janë mungesë, po ashtu mungon hapësira për një fushë sportive, pyetjen tjetër e kam prapë për Drejtorin e Arsimit, dua ta di në sa ora hapet shkolla, sepse nëse i dërgon fëmijët në ora 7:05 mëngjesit, në Aneksin - 1, duhet fëmijët të rrinë jashtë, prindërit kanë vështirësi, sepse shkojnë për puna dhe i dërgojnë me herët, ndërsa unë stafin në atë kohë e shoh duke pirë kafë, s'po kuptoj, pse nuk rrinë dera hapur. Dua të parashtrij pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, dua të kthehem prapë tek çështja e drunjëve, pash një rrugë, ku tash ka filluar, vendosja e drunjëve dhe me sa mbaj mend unë, ju keni thënë, ka një standart, druni prej druni kur të mbjellët dhe unë i pash disa lokale, ku kishin filluar që të praktikojnë, në tre metër, kishin qenë të vendosur tre drunjë. Këtu i bjen që afër një lokali ne investojmë afër 1,500.00€, për me ja krijuar një lokali, një pamundësi të parkingut të makinave dhe mos pasur nevojë ata me ardhur me marrë një leje, për me bllokuar atë hapësirë. Kolegu z. Hasan Ismajli, i cili e propozoj një pikë, nuk kaloj dhe me duhet ta përmend, sepse u bë e tepërt lirimi i hapësirave publike, te cilat po uzurpohen. Ne kemi ardhur ne një pozicion, ku mbjellja e drunjëve dhe hapësirat qysh janë duke u uzurpuar, nuk e di qysh nuk po ju pengojnë, për mos reagim të Drejtorisë së Inspektoriatit, ju ka vështirësuar jeta qytetarëve. Po ashtu pash një listë, të subvencioneve në arsim, aty pash 3-4 emra të fëmijëve të zyrtarëve, drejtorëve dhe desha ta pyes Drejtorin e Arsimit, a'ka konflikt interesi, kur një drejtor ka dy fëmijë jashtë vendi për studime

dhe merre bursë, po ashtu pyetja ime, është që në vazhden e nevojave të qytetit, a'i kemi ne mundësitë mi ndarë 400,000.00€?

Hasan Ismajli: Në mbledhjen e fundit, unë i kam parashtruar disa pyetje, mirëpo nuk kam marrë përgjigje, po ashtu një pyetje kam bërë tek Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili zakonisht nuk ka përgjigje këtu, sepse thotë që ua kthej me shkrim, mirëpo unë përgjigje nuk kam marrë. I nderuari Nënkyetar i Komunës, unë kam bërë kërkesë me shkrim për Drejtorin e Gjeodezisë, Kadastrit e Pronës dhe Drejtorit të Planifikimit Urban, të cilën e kam protokolluar me datë: 30.09.2024, për pikën e rendit të ditës, e cila ka qenë mbledhjen e kaluar, 'Dhënia në shfrytëzim e ngastrës kadastrale tek tregu për Ndërtimin e Xhamisë', unë absolut nuk jam kundër Xhamisë, por unë kam kërkuar dokumentacion që ligjërisht, a janë këto prona unike në tërësinë e tyre dhe kamë kërkuar nga Drejtori i Planifikimit Urban z. Parayll Zogjani, si ka me bërë ndërrimin e pronës aty për ndërtimin, ku me Hartë Zonale të Komunës, parashihet diçka tjetër dhe Drejtori i Planifikimit Urban z. Parayll Zogjani, ka dalë në foltore dhe na ka treguar, se bënë edhe për Xhami. Kam kërkuar ngastrën kadastrale, në të cilën kam pasur vërejtje edhe mbledhjen e kaluar, ku ngastra kadastrale prej 27 ari, ka numër të veçantë, ndërsa në grafik ku është e vizatuar edhe objekti i xhamisë, është i ndarë dhe ka numër tjetër dhe ne i kemi votuar 27 ari, unë s'kam marrë përgjigje nga Drejtorët. Dua të parashtrroj një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit z. Ali Topalli, keni dhënë një subvencion dhe me rregullore, e keni përveç formimit të komisionit i cili i përzgjedh përfituesit, e keni edhe një komision monitorues, që i monitoron projektet që ju i keni financuar, pyes a keni formuar dhe atë komision dhe atë kanë informuar deri ku ka shkuar përfundimi i atyre projekteve, që ju i keni financuar, sepse në fund të viti ju duhet me u barazuar. Unë pash që ja kishit lejuar 1,800.00€ subvencion, për festën e shtetësisë së shtetit të vetë, e cila ishte në maj të vitit të kaluar, ndërsa ju e keni financuar në këtë vitë, nuk e di si keni me u barazuar, është mirë me na treguar. Nënkyetar i Komunës, po ju drejtohem juve, sepse kur unë kam pasur problem me nja dy-tri prona, ju me keni thënë nuk është ashtu, siç po thoni ju. Prona tek tregu, te cilën e menaxhon z. Halil Berisha, në fillim të këtij muaji është e pa realizuar, prona është e dy serbëve, para disa viteve, kjo pronë është këmbyer, ju ka marrë aty dhe ju kanë dhënë këtu tri shpija dhe kjo është ndarë në grafikë, në fillim të këtij muaji punëtorët e kadastrit e kanë ndarë, ndërsa unë këtu e kam kërkesën e tyre, të cilën e kanë bërë me datën katërmëdhjetë, ende pa u bërë kërkesa, kjo grafikë është ndarë, ngastra kadastrale është midis tregu, për afërsisht katër ari, merruni me të Nënkyetar i Komunës, sepse kjo ka me u shitë dhe kjo ngastër kadastrale para dy viteve, një zyrtar është grushtuar nga një palë, e cila e ka pasur autorizimin për me shitur këtë pronë dhe i kanë thënë nuk bënë, sepse kjo pronë është pronë komunale. Një zyrtar aty e cila bën siç dëshiron, ndërhyr në grafikë, ai zotëria ka interes material. Drejtori i Planifikimit Urban z. Parayll Zogjani, iku sepse e ka pikën 'Informim për Planin Zhvillimor Komunal dhe materialin ua dorëzoi Lidhjes Demokratike të Kosovës, Partisë Demokratike të Kosovës dhe Vetëvendosjes, ndërsa partive tjera nuk u'a dorëzoi, këtë që ua dorëzoi, unë e di dhe e kuptoj më mirë se ai. Kjo shpija Nënkyetar i Komunës, e cila është përball meje, dy kate e gjysmë, nuk ka leje ndërtimore, nuk është e legalizuar, ndërsa Drejtori i Planifikimit Urban jep mbi ndërtim leje të përkohshme, jashtë ligjshëm dhe kjo është interes personal material i Drejtorit në fjalë, unë mendoj se duhet me

reaguar, ju mundeni me shkuar dhe me vizituar, kur një person ka shkuar dhe është ankuar për rastin në fjalë, ai përgjigjet, unë e di se çka bëjë dhe vendosi vetë.

Migjen Kolshi: Përshëndetje për të gjithë, po ashtu përshëndes Kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës - dega në Fushë-Kosovë, po filloj me pyetjet për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, konkretisht për fshatin Harilaç, në të cilin ndriçimi ka filluar para tre-katër muajve dhe fshati Harilaç nuk ka ndriçim publik. Unë e ngriti vazhdimisht këtë çështje dhe nuk është ndërmarrë asgjë, nuk e di si nuk po ju vjen keq për këtë fshat, në të cilin nuk ndërmerrni asnjë hap dhe nuk kryeni as një punë. Rruga 'Amir Elmazi' tek shkolla Aneksi – 3, për ju Nënkyetari i Komunës ua kam dërguar edhe fotografi se si fëmijët kalojnë andej për të shkuar në shkollë, në momentin që fillon një shi rruga bllokohet, unë pyes Nënkyetarin e Komunës së Fushë-Kosovës, a keni ndërmarr diçka në lidhje me këtë çështje, që fëmijët të kenë më lehtë, që të shkojnë në shkollë. Po ashtu dua të pyes, për furnizimin me lëndë djegëse (dru), unë nuk dua që ta fajësoj Drejtorin e Arsimit, por pikërisht Kryetarin e Komunës, sepse atij nuk i intereson për këtë çështje, në fshatin Harilaç, javën e kaluar ka pasur dru për ngrohje, vetëm edhe tri ditë, unë personalisht kam bërë kërkes tek Drejtori i Arsimit dhe e kam sjellë edhe një pjesë, por përafërsisht 4-5 ditë, edhe këto shpenzohen. Kam edhe një çështje që dua ta ngriti, i nderuari kolegë z. Hasan Ismajli, pagesa për Sh.p.k-së 'Dreni', e cila u ngrit si çështje edhe në media, për pagesën e Sh.p.k-së 'Dreni', ka marrëveshje me komunën në çdo tender, për lejen e automjeteve, këtë e kam ngritë unë në vitin 2019, ka qenë shuma e mjeteve financiare prej; 247,000.00€, unë kam pyetur dhe përgjegjëja, e cila me është kthyer nga Ekzekutivi i Komunës është se, ato mjete të cilat qytetarët i paguajnë dënimet shkojnë në polici dhe Komuna e Fushë-Kosovës, merr të hyra prej dënimeve të automjeteve, pastaj ato mjete barten në Komunën e Fushë-Kosovës dhe Komuna i'a bartë Sh.p.k-së 'Dreni' dhe unë personalisht këtë e kam besuar. E pash edhe një koment i nderuari z. Hasan Ismajli, në të cilin e kishe akuzuar opozitën, që nuk keni përkrahje, unë me sa e di, nuk të ka penguar, as një opozitar me ngrit këtë çështje, nuk është etike me akuzuar opozitën, sepse asnjë nuk ta kemi ndalur punën. Në vitin 2021, e dimë shumë mirë, se ju keni kontribuar më së shumti, për me ardhur kryetar, z. Burim Berisha, sepse keni pasur koalicion dhe kjo është e drejtë e jotja, mirëpo nuk është e drejtë me e akuzuar askënd.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përshëndetje për të gjithë, po ashtu përshëndes Kryetarin e Degës së Partisë Demokratike të Kosovës z. Rrahim Tërnavë. Unë dua të parashtoj një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, sepse të gjithë jeni në dijeni, se kemi probleme me tensionet e rrymës. Jemi 1000 shtëpi, me 5000 banorë dhe kemi shumë probleme të furnizohemi me energji elektrike, për arsye të mungesës së trafave, ky problem është kryesisht në tri lagje, reduktimet e energjisë elektrike janë të shpeshta, po ashtu ka pasur raste që kanë mbetur pa rrymë një javë. Kërkoj bashkërisht të punojmë, e të shohim se çka mundemi me bërë në këtë drejtim. Po ashtu edhe kabllot e rrymës janë 1.50m larg tokës dhe janë shumë rrezik për fëmijët. Problem kemi edhe tek kamionët e Kompanisë së Pastrimit, sepse e kanë vështirë ta kryejnë punën e tyre. Ju lutem keni konsideratë dhe punoni në këtë drejtim për të mirën e komunitetit tonë.

Qëndresa Ademi: Përshëndetje për të gjithë, unë e kam kërkesën e njëjtë si kolegut z. Bashkim Krasniqi, po ashtu dua ta potencoj se këtë kërkesë, unë e kam ngrit prej se jam në këtë mandat, mirëpo askush nuk është marrur me kërkesën time. Para se të digjet trafio, në lagjen tonë është djegur edhe shtylla elektrike, para shtëpisë sime, KEDS-i ka ardhur në vendin e ngjarjes, ka intervenuar, por s'ka pasur mundësi, me ndërruar, ejani dhe shikoni gjendjen e komunitetit tonë, sepse komplet lagjet e komuniteteve janë në këtë gjendje dhe nuk mundemi në zgjedhje me ju thënë votuesve, kemi me përmirësuar gjendjen e juaj, kur gjendja e komuniteteve është e njëjtë për 20 vite, mua më vjen keq me shkuar dhe me kërkuar votë, edhe një herë prej tyre.

Aida Alimi: Përshëndetje i nderuari, Kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës, Nënkrjetar i Komunës dhe gjithë ju të pranishëm. Kam një pyetje për Nënkrjetarin e Komunës, pse tash e tri vite, unë kërkoj që Këshilli i Sigurisë, me ardhur dhe me na raportuar, për rastet të cilat ndodhin në Komunën e Fushë-Kosovës. Pyetjen tjetër e kam për të gjitha Drejtoritë Komunale, pse nuk merreni seriozisht, me kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, të cilat janë të shumta dhe ju ato i leni në sirtarë. Po e ri përsëris pyetjen, për bllokimin e rrugës tek 'Kompleksi Linda 4', e cila është pronë publike dhe është e bllokuar nga qytetarët, unë kam biseduar edhe me Drejtorin e Inspektoriatit, i cili më ka thënë se do të merrem sa ma shpejt, me këtë çështje dhe s'është ndërmarrë asgjë. Ju kisha lutur të ndërmerrni diçka për qentë endacak, të cilët janë shumë rrezik për qytetarët. Dua prapë ta ngriti çështjen e lokaleve tek Stadiumi i Qytetit, të cilat po zhvillojnë dukuri negative dhe askush nuk merret me këtë çështje.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje për të gjithë, po ashtu përshëndetje edhe për Kryetarin e Degës së Partisë Demokratike të Kosovës, desha t'i parashtroj disa pyetje, për Drejtorin e Arsimit, mirëpo meqenëse nuk është prezentë drejtori po i'a parashtroj Nënkrjetarit të Komunës. Nënkrjetar i Komunës në vitet e 90-ta, fëmijët e kanë ndaluar mësimin, për shkak të mungesës së ngrohjes, në klasën e vajzës ime, javën e kaluar, ju ka ndër prerë mësimi për arsye të rrymës, mungon ndriçimi. Pyetjen tjetër e kam për Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, katër automjete janë në QKMF-në në Fushë-Kosovë, ndërsa në AMF-në në fshatin Sllatinë e Madhe nuk ka, mirëpo nëse ka ndonjë rastë emergjent, ambulancën duhet ta presim deri të vijë nga Fushë-Kosova.

Shpend Bardiqi: Përshëndetje për të gjithë, çështja e ndriçimit publik, po diskutohet në secilën mbledhje, tash po errësohet më herët dhe qentë endacak janë problemi kryesorë për qytetarët, dua ta di deri ku ka shkuar procesi, sepse më herët jeni arsyetuar tek kontrata, tash keni kontraktuar kompani të re dhe një lagje punon, një lagje nuk punon, po ashtu në fshatin Kuzmin funksionon ndriçimi, ndërsa në lagje tjera, herë nalen, herë lëshohen dritat. Pyetjen tjetër e kam, për Drejtorinë e Infrastrukturës, shumë mirë që e keni qitë edhe një katë komunës, keni shtruar asfalt por deshta të pyes se a keni ndër marrë ndonjë veprim, që kur të bie shi, mos me na marrë uji, nëse po cili është ky veprim, sepse rrugët e qytetit po bëhen si liqen kur po bie shi. Punimet të cilat, kanë qenë në objektin e komunës, kanë qenë pa asnjë rregull, s'po pyes për tjerat, sepse ju nuk jeni në gjendje një parking me liruar e lerë më shumë. Kam në pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë, është rregull me qitë një listë live të stokut të barnave të cilat janë në QKMF-në, dhe më është thënë, që e kemi qitur, mirëpo unë nuk e kam parë. Unë e kam parë një letër A4 -kemi para cetoll dhe disa të tjera,

një komunë me shumë buxhet, nuk është në gjendje me vendos një listë live të stokut të barnave, neve jemi informuar nga Ministria e Shëndetësisë që Komunitat janë të obliguara të qesin stokun e barnave të cilat ndodhen në QKMF-në, vjedhja më e madhe e barnave bëhet këtu, sepse mirën barnat prej QKMF-së dhe shkojnë shitën nëpër barnatore.

Jahush Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë, u përmend ndriçimi publik edhe nga disa kolegë, unë dua të parashtoj pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, në fshatin 'Bardh i Vogël', ndriçimi publik është jo funksional, po thuaj se 90%, a' ka planifikuar drejtoria që ky shërbim të ju ofrohet edhe qytetarëve të Bardhit të Vogël', nëse po kur do të realizohet, pyetjen tjetër e kam, për Drejtorinë e Infrastrukturës rruga 'Gjon Buzuku', që lidh fshatin 'Bardhë i Vogël me fshatin Pomozotin', është shtruar pjesërisht, kur do të shtrohet pjesa tjetër?

Doruntina Jashari: Përshëndetje për të gjithë, po filloj me Drejtorin e Infrastrukturës, rruga 'Hajrulla Zymi', kur do të filloj largimi i terasave dhe reklamave të bizneseve, sepse për arsye të zgjerimit të rrugës, shumica e trotuareve janë të pa kalueshme, sidomos për karrocet, qoftë të fëmijëve apo personave me nevoja të veçanta.

Habib Mekolli: Përshëndetje për të gjithë, kam një pyetje për Nënkrjetarin e Komunës, dje kemi dëgjuar që shkolla në 'Lismir' kishte problem prej minjve, ishte një kronik televizive, ku shumë nxënës të asaj shkolle, paraqitshin ankesë, udhëheqësi i asaj shkolle tha, se ne e bëjmë pastrimin dhe dezinfektimin e shkollës, mirëpo do vrima mbesin prapë të hapura dhe për ato vrima po depërtojnë minjtë. Nënkrjetari i Komunës tha se fajtor është niveli qendrorë, sepse ne e kemi planin për një shkollë të re, mirëpo ajo duhet mu bërë me impiantin dhe ajo po vonohet. Pyes, a është fajtor niveli qendror edhe për vrimat, sepse unë besoj se nëse mbyllen vrimat, nuk e besoj se do ta kenë këtë problem dhe zhvillimi i procesit mësimor do të jetë në rregull. Po vazhdoj me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, a'ka mundësi të na jepni ndonjë informatë, për shërbimin e merimangës, sepse disa zyrtar policor na u kanë ankuar, se në mungesë të saj, po kanë telashe edhe me qytetarët e pa ndërgjegjshëm. Për Drejtorinë e Planifikimit Urban, në bazë të Hartës Zonale të Komunës, të aprovuar nga ky Kuvend i Komunës së Fushë-Kosovës, e që jepen leje për ndërtime të reja, së paku kam shpresuar se do ketë një rregull më të mirë se në pjesën ekzistuese për ndërtime të larta. Mirëpo kohëve të fundit po shohim se distancat ndërmjet ndërtimeve janë edhe më të afërta dhe unë mendoj, që në bazë të rregullave ligjore nuk është mirë kështu, pyes a' kanë leje ndërtimore të gjitha këto objekte kolektive të banimit?

Vlonjat Hasani: Përshëndetje për të gjithë, Unë çdo here po filloj me çështjen e rrugës 'Lumi' në fshatin Miradi e Epërme, që nuk ka asgjë për rregullimin e kësaj rruge, ndërsa ne deri sa të shohim një vendim konkret kemi me përmend këtë rrugë. Desha të pyes, edhe për sallat sportive nëpër shkolla, aty ku ka mungesa të hapësirave, tash kur i kemi programet shkollorë për nder të 'Festës së Flamurit', programit t'i mbajmë nëpër klasa, për arsye të hapësirës. Kolegëja, e ceku më herët, mungesën e energjisë elektrike, ku ka mungesë të investimit për gjenerator, nëpër shkolla, të cilët në orarin e pasditës detyrohen nxënësit që të humbin mësim, po ashtu në disa shkolla ka mungesë të gjërave elementare për higjienë, po ashtu mungesa e pajisjeve nëpër kabinetet e shkollave, unë pyes, kur do i siguron kabinetet në ato shkolla të cilat nuk kanë kabinete, po ashtu çështja e shkollës në fshatin 'Lismir' dhe fajin që tentoi t'ia bartë Nënkrjetari i Komunës, nivelit qendror,

të nderuar z. Habib Mekolli, foli për shkollën të cilën, në sallën e sportit kanë mbi kërpudhat dhe për këtë nivel qendror s'ka faj, këtu ka mungesë të investimit dhe kujdesit të parasë publike. Rruga 'Hamdi Grajçevci' deri ku ka shkuar faza e asfaltimit, sepse ka ankesa që shaktat e kanalizimit kanë mbetur shumë naltë. Nënkryetar i Komunës jeni zotuar para neve, se keni me hartuar një rregullore për fushat e futbollit, e cila përcakton saktë se kush ka të drejtë, t'i mirëmbajë, t'i lirojë që t'i shfrytëzojnë, a na tregon se kur do të bëhet. Tek banimi social parashikohet, që janë ndarë edhe disa mjete financiare prej komunës, a na tregoni qoftë edhe një cent ku keni investuar. Kur keni me vendos me implementuar rregulloren për varime, sepse ka kaluar në Kuvendin e Komunës, qytetarët janë duke paguar shërbime, edhe pse me rregullore këta janë të liruar nga pagesa. Tregona cila është arsyeja e vonesës së zbatimit të kësaj çështjeje me rëndësi për familjet e komunës tonë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pyetje për Drejtorin e Arsimit, i cili nuk është prezent, çka po ndodh me mësimdhënësin e matematikës, në shkollën 'Zenel Salihu', sepse nxënësit nuk kanë mbajtur lëndën e matematikës afër katër muajve, po ashtu në shkollën 'Mihal Grameno', kanë humbur tre muaj në lëndën e Fizikës dhe tash ju ka ofruar një mësimdhënëse, mua më thërret një prind, i cili e ngrit shqetësimin dhe thotë, fëmiju im në klasën e gjashtë, ende nuk e ka mbajtur lëndën e Historisë, pyes çka po ndodh?

Nënkryetari i Komunës: Përshëndetje për Kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës. Unë për disa pyetje të cilat mi kanë parashtruar asambleistët, nuk kam informacion. Por për ato të cilat kam informacione, unë do përgjigjem, por një pjesë të madhe do të përgjigjen edhe Drejtorët e Drejtorive. Ngrohja në institucionet shkollore, furnizimi me dru në shkollat fillore dhe të mesme, kanë një sasi të pa mjaftueshme për me kaluar sezonin dimërorë, disa shkolla kanë pasur deri në pranverë, por disa kanë pasur sasi shumë të vogla. Me datën 26.07.2024, ne kemi bërë një kërkesë në KEK-ut, i cili është përgjigjë pozitivisht në kërkesën tonë dhe na ka lejuar 500 ton thëngjill që mund të përdoret nëpër shkolla, por transporti të bëhet nga ana e Komunës së Fushë-Kosovës. Ne jemi detyruar të fillojmë procedurat e prokurimit për transportin e këtij thëngjilli, i cili është ofruar nga ana e KEK-ut, kjo ka përfunduar, është nënshkruar kontrata dhe operatori ekonomik dje ka filluar furnizimin dhe shpërndarjen në të gjitha shkollat në Komunën e Fushë-Kosovës, në sasinë prej 500 tonëve. Ndarja është bërë nga Drejtoria e Arsimit, varësisht nga madhësia e shkollës. Në muajin gusht kemi filluar me procedurën e prokurimit, për blerjen e druve dhe për momentin, kjo lëndë është në ankesë në OSHP, e jemi duke pritur për përgjigjen nga OSHP-ja, nëse përgjigja do të jetë pozitive do të nënshkruhet kontrata dhe do filloj edhe furnizimi me dru, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Fushë-Kosovës. Besoj se do ketë rezervë për dy vitet e ardhshme. Deri tani nuk ka ndodhur që të kemi mungesë në shkolla për arsye të druve, por ka qenë mungesa e prishjeve të pompave të ngrohjes dhe deri sa janë ri instaluar, ose ka pasur mungesë të energjisë elektrike, e jo për arsye të mungesës së drunjëve, aty ku kemi pasur gjeneratorë, ka vazhduar furnizimi me ngrohje. Sa i përket normave, kemi 23 norma në nivelin klasor dhe 35 norma në nivelin lëndorë, të cilat janë të pa financuara dhe vazhdojnë punën. Ne jemi drejtuar disa herë në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit në lidhje me këtë, shkresa e fundit për këto norma, që unë po i përmendi është dje në mëngjes, i kemi dërguar shkresë Ministrisë së

Arsimit, sepse janë norma te cilat sipas kriterëve të ligjit plotësohen dhe është obligim i Qeverisë së Kosovës, që t'i vendos në ligj dhe t'i financoj dhe ne të kemi mundësi me i paguar, keni parasysh që sistemi i arsimit në Komunën e Fushë-Kosovës, gjithmonë po është në rritje dhe po sjellë kërkesa për norma më shumë. Në janar ne do të vijmë me prezantimin e ri, për normat e reja që do të vijë në Kuvendin e Komunës. Propozimi i juaj, që të hynë si pikë shtesë e rendit të ditës, 'Lirimi i hapësirave publike', i cekur nga ju sidomos në rrugën 'Dardania' e cila nuk kaloi, jemi dakorduar me pjesën e Ekzekutivit të Komunës, ku është obliguar Drejtorja e Inspektoratit dhe Drejtorja e Planifikimit Urban, që të bëjnë planin për lirin e këtyre hapësirave, të jetë plan gjithëpërfshirës me gjendjen në teren dhe të vijave ndërtimore, të jetë i detajuar, në aspektin financiar dhe ligjor, afati të cilit i'u është dhënë dy drejtorive për këtë plan është deri më 31.01.2025. Komuna ka filluar procedurat e kontraktimit për rrënim, në rastet kur nuk ka pëlqim nga ata të cilët kanë uzurpuar hapësirat publike, barra e shpenzimeve do të bie mbi ta. Rruga 'Hajrulla Zymi', besoj se Drejtori i Infrastrukturës do të vijë me një informacion më detaj rreth rrugës, mirëpo ajo që jemi munduar me KESCO-n të bëjmë është, që ta lirojmë hapësirat nga të gjitha shtyllat, ta lejmë një parking horizontal për automjete, sepse do jetë një rrugë me gjerësi 8m. Ne e dimë se rruga 'Hajrulla Zymi', është rruga më e frekuentuar pas rrugës 'Dardania'. Një pyetje ka qenë, në sa ora hapet shkolla në Aneksin 2, unë e marrë përsipër dhe në mbledhjen e radhës ju njoftoj, se a'po respektohet orari i shkollës. Nuk do i kërkoj stafit, që të shkojë më herët, por nëse nuk e hapin shkollën me orarë, do të interesohem pse shkolla po hapet më vonë. A ka komision për monitorim të subvencioneve, unë e di që ka me sa kam informacion, mirëpo drejtori mundet me na ndihmuar. Ndriçimi Publik në fshatin Harilaç dhe Bardh i Vogël, ne kemi pasur një kontratë për intervenimet e ndriçimit publik, mirëpo kjo kompani tash u shpenzuar dhe tri fshatra i kemi keq me ndriçim publik në fshatrat: Harilaç, Graboc i Poshtëm dhe Bardh i Madh, në fshatin Graboc i Poshtëm në një pjesë është intervenuar, ne jemi në procedurat për një kontratë të re dhe do vazhdojmë me këto tri fshatra, sa më shpejt që është e mundur. Rruga 'Amir Elmazi' është e planifikuar edhe me buxhet, e të cilën e kemi miratuar bashkë në Kuvendin e Komunës, tash vazhdon me procedurat e prokurimit ku do të nënshkruhet kontrata dhe do të rregullohet rruga 'Amir Elmazi'. Dua të jap përgjigje edhe për Sh.p.k 'Drenin', ne nuk kemi më kontratë me 'Drenin', është një kontratë e përfunduar, ne po paguajmë sipas vendime gjyqësore për këtë kompani, në bazë të një kontrate, e cila ka qenë më herët, kjo e ka dëmtuar shumë buxhetin e Komunës. Sa i përket trafove, është në kompetencën e një operatori privat, nuk është as e KEK-ut, as e Komunës, kjo është kompetencë e KESCO-s, që të bëjë intervenime të cilat janë të nevojshme, unë për lagjen 028 dhe 029, në momentin që kam dëgjuar, menjëherë jam interesuar, jo të financojmë nga ana e komunës, po të paktën të bashkëpunojmë me KEDS-in dhe të intervenohet sa ma shpejtë. Më kanë lajmëruar pas 90 minutave, që trafo është rregulluar dhe pas dy ore u rikthye në funksion. Unë siç jam i informuar që KESCO, ka bërë intervenimin dhe riparimin e nevojshëm në lagjen 028 dhe 029. Pyetja tjetër rreth qenve endacakë dhe lokaleve rreth Stadiumit për të cilat jam i informuar që ka dalë edhe policia edhe inspektorati, ka edhe gjoba, është një aktivitet i cili sa hapet, edhe mbyllet, unë personalisht me Drejtorët e Drejtorive kam qenë prezentë në takime me policinë dhe kemi biseduar, si ta bëjmë një zgjidhje për këtë çështje. Sa i përket qenve endacakë jemi shumë keq, sepse ne bazë

të raporteve që vinë nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, kemi dy deri në tri raste brenda 24 orëve dhe çka është më shqetësuese, se 99% e rasteve janë të gjinisë femërore. Jemi munduar me i lokalizuar zonat ku po ndodhin dhe jemi duke u munduar me bërë një intervenim me Komunën e Prishtinës, sepse nuk kemi të drejtë me i asgjësuar, ende nuk kemi një strehimore, ende s'kemi një plan regjional për trajtimin e çështjes së tyre, me masa adekuate, pak më të mirë e kemi gjendjen kohën e fundit. Urgjencat nëpër vendbanime ajo çka kemi mundur me bërë me stafin, ne e kemi bërë, kemi vazhduar me ndërrimin e dytë në fshatrat: Sllatinë e Madhe dhe Bardh i Madh, që t'ju ofrohen shërbime me një orarë më të gjatë, e cila nëse nuk gaboje është deri në ora 19:00h. Jemi duke provuar me bërë në fshatrat: Vragoli dhe Miradi e Poshtme, që përveç Qendrës së Mjekësisë Familjare, të kemi edhe tri qendra, që ofrojnë shërbim deri në ora 19:00h. Mirëpo nuk kemi mundësi që një emergjencë, ta lëmë në fshatin Sllatinë e Madhe apo Bardh i Madh, sepse nevojat e qendrës janë aq të mëdhaja, sa që ne nuk kemi 4-5 vozitës, që të vendosen në pika të ndryshme, koha e intervenimit është e mirë brenda standardeve evropiane. Vitin e ardhshëm do të bëhet ndërtimi i Qendrës Shëndetësore në Komunën e Fushë-Kosovës, sot ekipi jonë është duke punuar, me Ministrinë e Shëndetësisë, për hapat teknik dhe në janar do fillojmë me procedurat, është një projekt tre vjeçar, i cili financohet gjatë tri viteve të ardhshme. Sa i përket pyetjes për varrezat, ne po realizojmë obligim tonë si komunë, ne kemi një marrëveshje me Bashkësinë Islame, tarifat janë të miratuara nga ana e këtij Kuvendi të Komunës, e gjithë shuma është në dispozicion të Bashkësisë Islame, të gjitha mjetet financiare ne i dërgojmë tek Bashkësia Islame, pagesat bëhen çdo herë me kohë, ashtu siç është në rregullore edhe në marrëveshje, këtë vit shuma e mjeteve financiare ka qenë 60,000.00€ dhe me propozimin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, shuma e mjeteve financiare ka arritur në 90,000.00€, me miratimin e juaj në buxhetin e vitit 2025. Raportimi i Këshillit të Sigurisë, ne kemi mbajtur mbledhjen e këshillit kemi përgatitur raportin, këshilli i ka propozuar Komandantit Policor, që të vijë në emër të këshillit dhe të bëjë raportimin në Kuvendin e Komunës, për korrektësi të Komandantit Policor, ka qenë i gatshëm me ardhur me i bërë raportimet në Kuvend, mirëpo për arsye të pikave të shumta të rendit të ditës, ka mbetur për mbledhjen e radhës, sepse materiali është i gatshëm dhe do të vijë. Sa i përket pyetjes për stokun e barnave, ajo që di unë, nuk jemi keq me stokun e barnave, me listën esenciale dhe listën komerciale, ka barna të mjaftueshme, mund të kemi mungesa ditore, po ashtu mund të kemi edhe raste nga dikush që mund të thotë nuk është, mund të kemi edhe keqë kuptime, një ditë më ka thirrur një qytetare dhe më tha se në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, po vjedhin barnat, unë i thash mos me thirr mua, por thirr policinë, sepse më shpejt shkon Policia se sa unë, më tha jo, po dua që ta tregoj ngjarjen nëse keni durim, tha unë jam pre, jam lënduar dhe duhet me shkuar me marrë një vaksinë e cila kushton 45.00€ dhe unë e di se kjo vaksinë ekziston në shtëpinë e shëndetit dhe nuk ma kanë dhënë, më kanë thënë që duhet me shkuar me blerë, i kam besuar, kam shkuar dhe e kam gjetë rastin menjëherë, qytetarja jeton në Komunën e Fushë-Kosovës, mirëpo nuk është qytetare e Komunës së Fushë-Kosovës dhe sipas rregullave, ne nuk kemi të drejtë me ua dhënë përveç rasteve emergjente, ne kemi bërë zgjidhje tek ky rastë, por ne duhet të punojmë sipas rregullave. Sa i përket ekranit, kam dëshirë me pa nenin saktë ku është me ligj, që duhet me pasur

ekran, sepse unë e di se me ligj lista duhet me u bërë transparente dhe duhet me qenë e qasshme për qytetarët. U fol edhe për ekran, por drejtori përkatës besoj, se do të jep informacione, por me sa jam i informuar, vetëm sa nuk ka mbërri ekrani. Kam dëshirë me ardhur dhe me pa rrugën 'Lumi' dhe me pa mundësinë, sepse për disa mbledhje që kam qenë prezent, e keni ngrit si çështje. Tek shkolla e Lismirit, mua më është bërë pyetja, kur do të meremetohet shkolla në Lismir, përgjigjja ime ka qenë shumë e thjeshtë, shkolla në fshatin Lismir, nuk mendoj se do të meremetohet, sepse duhet të ndërtohet e re dhe me planin zhvillimor pritët vitin e ardhshëm të jetë rreth 400 nxënës, pyetja e dytë ka qenë pse nuk po bëhet tani, është zonë e cila do të ndërtohet impianti dhe është një marrëveshje e madhe ndërmjet Qeverisë së Kosovës, komunave të tjera dhe Komunës së Fushë-Kosovës, ku nga 28 milion euro në totalin e projektit, ku secili e bartë shumën e vetë për financim. Ne po e përdorim banimin social, për kontrata qiradhënie, për rastet të cilat nuk kanë kulme mbi kokë dhe janë raste të rënda sociale, rasti i fundit është dje, është me sëmundje dhe ka vetëm një fëmijë dhe është në gjendje të rëndë, nuk po e pranon askush në banesë me qera, për arsye të gjendjes shëndetësore, ne duhet të bëjmë shtëpinë për të moshuar dhe besoj se do vijë tek pika e rendit të ditës. Tani lajmi i mirë është që ju si anëtarë të Kuvendit të Komunës keni paga, lajmi i keq është që arsimit dhe një pjesë tjetër do kenë vonesa në paga, për arsye se mjetet financiare na janë marrë për zbatimin e kontratës kolektive.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sportit: Përshëndetje për të gjithë. Sot kam marrë pyetjet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, dua të përgjigjem në pyetjen e mbledhjes së fundit, nuk pashë që patë vërejtje në procesverbal, në pyetjen që më është drejtuar mua, nga z. Hasan Ismajli, keni subvencionuar një qytetarë në Bardh të Madh, unë dua ta di një mënyrën se si i keni dhënë këto të holla, me cilën Ligj dhe Rregullore, keni punuar, nëse keni mundësi me na treguar, përgjigjja ime është se të gjithë qytetarët janë të barabartë, pavarësisht prej cilit lokalitet apo mjedis janë. Pyetjet të cilat mi parashtruan sot, ishte çështja e komisionit të subvencionimit, ne i kemi të themeluar tri komisione, për ndarjen e subvencioneve, komisioni për monitorimin e implementimit të projekteve i themeluar me datën 18.03.2024 dhe jemi në proces të marrjes së raporteve nga Organizatat Jo Qeveritare, me të cilat obligohen që të na raportojnë, kanë pasur një afat i cili është përshtatur në pjesën e kontratës e cila është nënshkruar dhe ju kemi dhënë mundësi, që deri në fund të këtij muaji, për arsye se disa nuk janë përgjigjës dhe u'a kemi mundësuar që t'i dorëzojnë raportet e përfundimit të këtyre projekteve. Kërkesa e cila është bërë për Angela Dodorevic, këtë lëndë e kam këtu, ka aplikuar brenda thirrjes publike, komisioni e ka vlerësuar dhe janë mbështetur në bazë të rregullores për subvencione. Thirrja publike ka qenë me datën 18.03.2024. Lënda është e kompletuar dhe mundesh me ardhur me parë vetë. Të gjitha sallat që janë rregulluar, janë monitoruar me procesverbal i kemi dërguar Drejtorisë Komunale të Arsimit, dhe Drejtoria e Arsimit u'a dërgon shkollave, ne jemi ne rregull për salla. Sa i përket rregullores për fushat e sportit, jemi në proces.

Drejtori për Teknologji Inovacion dhe Integritim Evropian: Përshëndetje për të gjithë, unë nuk planifikoj diçka, çka nuk bëhet, procedurat e prokurimit kanë përfunduar, më vjen mirë që po shtohen kërkesat për këtë ekran, sepse unë e kam ideuar vetëm për funksionin e transparencës, ky ekran ka të bëjë për qytetarët më shumë, sesa për administratën. Prandaj secila drejtori, edhe e

Shëndetësisë e cila u përmend më herët, për listën e barnave, ne mund ta publikojmë, unë për atë dua që ky ekran të funksionalizohet. Ne kemi pasur vonesa në përgjigje nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinorë dhe Infrastrukturës, për arsye të pëlqimit për lokacionin, sepse nuk na kanë kthyer përgjigje.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Rruga 'Rexhep Mala' nuk ka pasur ku mu shkarkuar uji atmosferik dhe në buxhetin e vitit të ardhshëm, është një kod buxhetor e dini edhe ju dhe ka me u intervenuar, sepse nuk kemi shumë probleme tani në rrugë, nuk po mblidhet shumë uji. Probleme kemi tek rruga 'Amir Elmazi' dhe 'Rexhep Mala' por këto vitin e ardhshëm do rregullohen. Përgjigja ime për distancën rreth drunjëve është orientuese dhe nuk është e caktuar me pika gjeodezike, ku kanë me u vendos, në teren ndryshon gjendja dhe po mundohemi maksimalisht me dal sa më mirë. Qëllimi i projektit ka qenë, që me mbjell sa më shumë drunjë sidomos në rrugën 'Dardania' dhe ne aty kemi vendos aq sa kemi mundur. Ndriçimi publik në Bardh të Madh, është në përfundim. Me tensionin e rrymës po kemi probleme, kërkesat po i bëjmë vazhdimisht në KEDS. Ndriçimi publik, si po ngarkohet po e qet siguresa, po ashtu të gjitha problemet nuk varen vetëm prej neve, mirëmbajtja e ndriçimit publik ka përfunduar në fshatrat: Graboc i Poshtëm, Pomozotin, Bardh i Vogël dhe Henc, por në disa pjesë të tyre kanë mbetur ende edhe disa punë pa u rregulluar plotësisht, por atje Kompania është duke punuar dhe jemi në proces.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Dua të ju informoj, se duhet patjetër me përfunduar tash një pikë të rendit të ditës, formimin e Grupit Punues për hartimin e 'Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025' para kohës së pauzës.

Hasan Ismajli: Kryesues ky zotëri këtu, ka qenë asambleistë në mandatin e kaluar 2013/2017, në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovë, si të dilni në oborrin e Komunës i shihni tri shtëpi përballë, unë jam rritur këtu dhe e di, këtij personi ju ka marrë prona tek tregu shumë vite më herët, ju ka dhënë prona aty dhe ju ka ndërtuar, sepse ju ka ndërtuar, edhe shtëpia deri sa ka qenë mandat katër vjeçar, nuk i ka ra ndër mend me i marrë pronën aty, tani para disa muajve, e ka shitur këtë pronën me gjithë vëllezër, ka shkuar në Serbi dhe gjen lidhje aty dhe vjen me shitur pronën, edhe njëherë, këtë e din Drejtorja e Kadastrit shumë mirë, po ata po duan me u pasuruar. Çështja tjetër, del këtu Drejtori i Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe thotë kam komision monitorues, e bjen znj. Fitore Simnica, e cila është në pushim të lindjes dhe z. Ideal Berisha i cili është punëtorë me Projektin e Karitasit, kjo nuk është në rregull kështu, kjo qasje jo serioze ndaj neve kur pyesim dhe kërkojmë sqarime për shpenzimin e buxhetit.

Vlonjat Hasani: Desha të lidhem tek Nënkryetari i Komunës për rregulloren e varrezave, unë thash kur do ta implementoni rregulloren e varrezave, e cila e rregullon shpenzimet e varrimit, që janë të caktuara qartë në rregullore, banimi tre vjeçar është i rregulluar me planin tre vjeçar të banimit, por duhet te parashikohen investime në ato objekte, sepse këtu në Kuvendin e Komunës ka ardhur dy herë dhe nuk është bërë asnjë investim.

Pika e tretë (3) - Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin

2025', hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës dhe theksoj, se tani në këtë Grup Punues duhet të hyn edhe komitetet e Kuvendit, secili për planin e vetë të punës, andaj ftoi Shefat Grupeve Parlamentare që të japin propozimet e tyre.

Laureat Gojnovci: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës për anëtarë të 'Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025', e propozojmë z. Jetmir Berisha

Habib Mekolli: Ne Lëvizja Vetëvendosje për anëtarë të 'Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025', e propozojmë z. Durim Hajra

Migjen Kolshi: Nga Partia Demokratike e Kosovës për anëtare të 'Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025', e propozojmë znj. Aida Alimi

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po ashtu në Grupin Punues do jenë edhe anëtarët e kuvendit të Komunës: Bashkim Krasniqi, Artan Asllani, Arbnora Kelmendi, Hasan Ismajli, Qëndresa Ademi dhe Radoman Doderovic, nga ana e Ekzekutivit të Komunës propozohet z. Amir Bullatovci dhe nga Administrata e Kuvendit të Komunës z. Hasan Gjyrevci dhe znj. Blerina Morina.

Zyrtari i Lartë për Kuvend dhe Komitete: Sqaroi se sugjerimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, sa i përket e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, është që me i shtuar edhe anëtarët e tjera të Komiteteve të Përhershëm që janë anëtarë të Kuvendit të Komunës, por edhe anëtarët në Komitete tjera funksionale, në mënyrë që të kemi një gjithëpërfshirje dhe ata të i përgatitin planet për Komitetet tjera për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Lidhur me zbatimin e këtij vendimi sipas sqarimeve që u dhanë më lartë, do ta bëjmë një punëtori, në fillim të muajit dhjetor.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025', me përfshirjen edhe të Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës.

U votua unanimitet nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovon 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025', me përfshirjen edhe të Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, në përbërje prej trembëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, kryesues i grupit;
 - 1.2 Amir Bullatovci - Drejtori i Administratës, anëtar;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.4 Blerina Morina - Zyrtare e Lartë Ligjore, anëtare;
 - 1.5 Jetmir Berisha - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.6 Durim Hajra - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar
 - 1.7 Aida Alimi - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.8 Arbnore Kelmendi - Përfaqësuese e Nismës Socialdemokrate, anëtare;

- 1.9 Hasan Ismajli - Përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
 - 1.10 Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtar;
 - 1.11 Artan Asllani - Përfaqësues i Listës Ndryshe, anëtar;
 - 1.12 Qëndresa Ademi - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtare dhe
 - 1.13 Radoman Doderovic - Përfaqësues i Iniciativës Qytetare Serbe anëtare.
2. Pjesë përbërëse e Grupit Punues të cekur në pikën një të vendimit për përgatitjen e planeve të punës së Komiteteve të Kuvendit, janë edhe anëtarët tjerë përfaqësues të subjekteve politike nga Kuvendi i Komunës, në kuadër të Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera të themeluara me vendimet e Kuvendit të Komunës, me zëvendësimet tjera në përfaqësim.

Koha e pushimit në kohëzgjatje prej një ore.

Pika e katërt (4) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale', ftoi Drejtorin e Administratës për sqarime, kjo rregullore e ka kaluar në shqyrtimin e parë, ka qenë në diskutim publik dhe nëse ka ndryshime, ju lutem të na i elaboroni ato.

Drejtori i Administratës: Ne si Grup Punues për përgatitjen e 'Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale', në bashkëpunim edhe me Ekspertin e Jashtëm, Zyrën Ligjore dhe Zyrën e Personelit, kemi bërë disa ndryshime në versionin e dytë, i cili ka ardhur për miratim në Kuvendin e Komunës, sa i përket ndryshimit nuk kemi, tek Kabineti i Kryetarit dhe as tek shumica e Drejtorive të Komunës, ndryshim kemi tek Drejtori e Administratës, ku sipas versionit paraprak Arkiva kanë qenë tek Sektori për Teknologji Informative dhe Arkivat, mirëpo tani ky sektor ka kaluar tek Sektori për Shërbime me Qytetarë dhe ndryshimi tjetër është tek Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për shkak se shumica e kompetencave kanë kaluar tani nga niveli lokal, në nivelin qendror, në Sektorin e Pylltarisë, ne kemi vendosur që Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ta ketë vetëm një sektor, pra Sektorin për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe këtu ka mbetur vetëm një zyrtar për pylltari, ndryshim kemi edhe tek emërtimet e pozitave dhe koeficienteve sipas katalogut të fundit, të cilin na e ka dërguar Ministria e Punëve të Brendshme dhe ky katalog na ka detyruar që edhe një herë t'i rishikojmë dhe t'i bëjmë emërtimet në përputhje me katalogun e vendeve të punës. Kjo rregullore është në pajtim me të gjitha ligjet dhe aktet tjera në fuqi. Kërkoj nga asambleistët unanimisht ta votojnë këtë rregullore.

Durim Hajra: E dëgjova me vëmendje Drejtorin e Administratës, për sqarimet e verzionit të dytë të 'Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale', ne në shqyrtimin e parë, e kemi dhënë një vërejtje dhe nuk është dashur

me u neglizhuar, sepse u deshtë me marrë dhe me parë se çka parasheh statuti për këtë çështje, me qenë se ne kemi një statut pak më unik sesa Komunat tjera, unë mendoj se fillimisht është dashur të merreni me Statutin e Komunës, i cili është dokumenti më i lartë në një organizim lokal. Pyes ligjërisht, a është dashur së pari të rregullohet Statuti pastaj me radhë tjerat, sepse ne rregullore tani i kemi disa drejtori të reja dhe këto, duhet jenë në harmoni me njëra-tjetrën. Propozoj që të filloj me ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës, po ashtu edhe stema e komunës, sepse Statuti jonë është i vitit 2012 dhe ka nevojë për ndryshime.

Hasan Ismajli: Sa i përket 'Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale', kjo rregullore mendoj se është e domosdoshme, sidomos për zyrtarët e komunës, sepse me Ligjin e ri të pagave, një pjesë e punëtorëve kanë qenë të dëmtuar me paga dhe kjo rregullore tani i favorizon, i ngrit në pozitat të cilat i meritojnë sipas profesionit dhe vendit të punës që kanë, kjo rregullore shkon në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe nëse ka vërejtje ministria e kthen, unë e di se Statuti i Komunës është shkelur, por nuk është hera e parë, sepse unë jam dëmtuar si asambleistë dhe e kanë shkelur statutin, sepse Statuti i Komunës thotë: që Komiteti për Politik dhe Financa, duhet t'i ketë 9 anëtarë dhe tek ne janë 7, në Komitetin për Komunitete janë 9, unë Projekt-Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale e përkrah për aprovim.

Drejtori i Administratës: Të njëjtën vërejtje e kemi dhënë, kur e kemi bërë ndryshim-plotësimin e Rregullores 152, mirëpo edhe atëherë e kemi sqaruar që Komuna e Fushë Kosovës, në Statutin e saj e ka dispozitën ligjore, nenin specifik që thotë se Administrata Komunale rregullohet përmes rregullores tek neni 48 i Statutit të Komunës. Nëse në vitin 2022, e ka kaluar ligjshmërinë rregullorja, besoj se edhe tani do ta kalon në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Durim Hajra: Në Statutin e Komunës të vitit 2012, drejtoritë janë të ndara dhe meqë kemi shtim të drejtorive të reja, duhet të jenë të përfshira në statut. Me sa unë kam njohuri në aspektin juridik, është gabim kjo. Duhet të plotësohet, ose të fshihet neni krejt i statutit, sepse këto akte të përgjithshme janë në kundërshtim me njëra-tjetrën tani.

Mirsad Qyqalla: Sa i përket 'Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale', ne kemi pasur një qëndrim në shqyrtimin e parë, sepse ne si Kuvend i Komunës nuk kemi qenë pjesëmarrës në këtë rregullore, kemi qenë të përjashtuar. Nënkryetari i Komunës na tha se kjo rregullore është obligim ligjor, e nëse është obligim ligjor, atëherë rregullorja për zgjedhjen e lagjeve dhe të fshatrave, a është obligim ligjor prej viti 2019 dhe asnjëherë s'ka ardhur në shqyrtim, as nuk është punuar nga Ekzekutivi i Komunës. Kjo rregullore është tendencioze, sepse ka pasur, edhe shumë rregullore tjera të cilat u deshtë me ardhur e s'janë ardhur, meqenëse neve s'na është dhënë mundësia me parë, pse u bërë edhe ky shtim i drejtorive, ne e kemi të pamundshme me votuar, sepse na kemi përjashtuar.

Drejtori i Administratës: Në Statutin e Komunës së Fushë-Kosovës, nuk ceket as një drejtori, neni 48 paragrafi dy i Statutit të Komunës thotë: Organizimi i brendshëm i drejtorive dhe sistemimi i shërbyesve civil në vend të punës, duhet të bëhet në bazë të rregullores për organizimin e

brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale, kështu që nuk është në kundërshtim statuti me rregulloren dhe as rregullorja me statutin.

Nënkryetari i Komunës: Besoj se ka nevojë me u sqaruar kjo që e tha z. Durim Hajra dhe me parë, se qarkullojnë dy versione tek statuti, sepse kur kam ardhur unë këtu e kam kërkuar dhe ka qenë e vështirë me u gjetë, mu ka deshtë me marr verzionin zyrtar kur është miratuar herën e fundit i cili është i aprovuar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, arsyeja kryesore ka qenë pikërisht kjo, janë tri modele që ligji i ka lejuar, të organizimit të organizatës, ligji në esencë thotë që rregullimi i brendshëm i komunës, bëhet me Statutin e Komunës, disa komuna me statut e kanë paraparë, siç është rasti jonë që të bëhet me rregullore, disa komuna e kanë paraparë me statut dhe nuk ka nevojë fare të vijë në Kuvend, sepse i takon direkt Kryetarit të Komunës, deri sa një grup i komunave e kanë lënë që organizimin ta bëjnë me statut, ne jemi tek grupi ku organizimi bëhet me rregullore, prej kohës kur kam ardhur unë, kemi fol për një çështje shumë të rëndësishme, për një zingjirë llogaridhënës, për forcimin e sistemit të brendshëm të Komunës së Fushë-Kosovës, mënyra e kësaj rregullorje që është bërë tani e rregullon bazën juridike dhe formale dhe hap një dritare të re dhe një horizont pikërisht për këtë, sepse për herë të parë, të gjitha drejtoritë, janë të specifikuar me përgjegjësit e tyre, përveç kësaj me rregulloren janë të specifikuar të gjithë titujt e pozitave të punës dhe e treta që nuk e keni ju, e lidhet me përshkrimin e vendeve të punës, për secilën prej këtyre pozitave ka përfunduar përshkrimi i detyrave të punës. Për herë të parë në Komunën e Fushë-Kosovës, do kemi një dokument për secilin punëtorë, sepse janë të ndara. Në komunë për arsye të mungesës së stafit, kemi punëtorë i cili ka detyra shtesë dhe me këtë rregullore tani do të dihet saktë se çka ka me bërë secili në vendin e tij të punës. I kemi shtuar edhe drejtoritë, të cilat janë shumë të nevojshme, kjo rregullore tani ka me pasur staf për t'i kryer të gjitha punët, kjo rregullore është bërë në pajtim me rezultatet preliminare të regjistrimit të popullsisë. Drejtoria për Çështje Sociale dhe Drejtoria për Emergjencë, është nevojë e kahmotshme që t'i kemi, po ashtu është bërë në pajtim me formulat buxhetore, që duhet me i takuar kësaj komune në të ardhmen, ka rritje të numrit të sektorëve, rritje të pozitave të punës dhe e cila nuk mund të zbatohet, pa u bërë ndryshimet tek ligji i buxhetit, pa u përfshirë edhe këto pozita, kjo rregullore nuk ka me vendos, me u ekzekutuar menjëherë, edhe nëse kalon tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kjo do të zhvillohet në proporcion gradualisht. Me shumicë të votave ky Kuvend i Komunës kur të donë mundet me ndryshuar këtë rregullore. Sa herë kemi dërguar ndryshime në sistemin e pagave kemi marrë listë me nënshkrim, ligji për shërbimin publik ka dhënë një afat ligjorë, që çdo institucion me i adaptuar ndryshimet e nevojshme në rregulloret e brendshme organizative, për me mundur me i aplikuar sistemin e ri të pagave, çka është aplikuar pa këtë rregullore në komunë, këtu u aplikuar vetëm ajo e cila ka qenë një me një, nëse ka pasur Kryetar Komune me ligjin e ri, u pranuar Nënkryetari i Komunës, por shumë pozita sot në shërbimin civil, vuajnë në mungesën e kësaj rregullorje, nuk kanë përshkrime të qarta. Statuti i stër vjetruar, por nuk mundesh me kërkuar kur ka shkuar me shumë se gjysma e mandatit dhe ky dokument donë 7-8 muaj kohë dhe nuk i'a vlen ne fund te mandatit me ndërruar.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për miratim në shqyrtimi e dytë 'Projekt-Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe katër abstenime, gjithsej njëzet pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e miraton në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.
2. Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën e Komunës së Fushë-Kosovës, përfshinë mënyrën e organizimit dhe rregullimin e brendshëm, përgjegjësit e njërive organizative, klasifikimin, sistematizimin e vendeve të punës në Administratën e Komunës dhe organogramin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës është shtojca Nr. 1 për klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe shtojca Nr. 2 për organogramin e komunës.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Planin të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026'. Hap diskutimin.

Laureat Gojnovci: Shqyrtimi i dytë i 'Projekt-Planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026', ky plan ka kaluar në shqyrtimin e parë, me respektimin e të gjitha procedurave të nevojshme, nuk ka pas ndryshim të madha dhe ne në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim.

Vlonjat Hasani: Sa i përket shqyrtimit të dytë të 'Projekt-Planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026', është neglizhencë totale e Ekzekutivit të Komunës, respektivisht Drejtorisë së Arsimit, kjo punë e paraqet një mos seriozitet në adresimin e kësaj çështje me shumë rëndësi.

Mirsad Qyqalla: Ne në herën e parë e kemi mbështetur, pjesa e prezencës në mbledhje, mendoj se është përgjegjësi që dihet, ne e mbështesim dhe e përkrahim për aprovim.

Artan Asllani: Në Komitetin për Komunitete, zyrtarja ka qenë dhe e ka prezantuar 'Projekt-Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026', ky plan është shumë i rëndësishëm, e sidomos për komunitetet, rom, ashkalinj dhe egjiptian, që jetojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, sepse e dimë që është në rritje shkalla e braktisjes, ku shkon deri 20%, kërkoj me u aprovuar ky plan dhe të filloj të zbatohet. Ne i kemi dhënë komentet e tona, është një plan gjithëpërfshirës.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Unë e mbështes shqyrtimin e dytë të 'Projekt-Planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkolla për

vitet 2024-2026', unë e di se është një ekip për parandalim dhe braktisje, por ata s'kanë dal asnjëherë në teren.

Vjollca Konjusha: Përshëndetje për të gjithë, dua të ndërlidhem tek parafolësi, në teren kemi dal tërë kohën, sepse unë kam qenë Kryetare e ekipit për parandalim dhe braktisje të shkollës jonë, kemi shkuar dhe i kemi vizituar nëpër shtëpia, por për dy vite, unë më nuk jam më pjesë e atij ekipi dhe më nuk e di se çka ka ndodhur në këtë periudhë kohore.

Fisnik Sllaminku: Sa i përket ekipit të 'Planit të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit', është me ligj dhe me rregullore, ne duhet me çdo kushte që ta ulim numrin e braktisjes nëpër shkollë, sidomos në Komunën e Fushë-Kosovës, andaj e presim mbështetjen e juaj në këtë punë me rëndësi për mbarëvajtjen e shkollës nga të gjithë nxënësit.

Nënkryetari i Komunës: Dua të ju njoftoj se, Drejtori i Arsimit është në Stamboll, ka me referuar një ndeshje, sepse ju e dini se është gjyqëtar ndërkombëtarë i futbollit, këtu nuk ka konflikt të angazhimit të tij në fushën e arsimit dhe në fushën e sportit, në bazë të ligjit të konfliktit të interesit, sepse kam qenë e interesuar, unë e kam thirrur sot Shefen e Arsimit, mirëpo ajo më tregoj, se në Kuvend nuk mund të paraqitet në vend të drejtorit, kërkoj të jenë drejtorët dhe për ata se prishem rendin, ne u munduam me mbuluar për aq sa patëm mundësi. Mirëpo tjera herë është mirë me autorizuar dhe me ardhur në mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit Nënkryetar i Komunës, është praktikë edhe e herave tjera, se nëse nuk është drejtori prezent, të jetë Shefi i Sektorit, mirëpo me qenë se ishte prezent Nënkryetari i Komunës, besoj se na u dhanë sqarime.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkollë për vitet 2024-2026'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovon në shqyrtimin e dytë 'Projekt-Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos regjistrimit në shkollë për vitet 2024-2026' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkollë për vitet 2024 - 2026, në të gjitha shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Plani i Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkollë për vitet 2024 - 2026, në të gjitha shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës, parasheh zhvillimin e punëve dhe aktiviteteve për parandalimin e braktisjes së shkollës.
3. Pjesë përbërëse e 'Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkollë për vitet 2024 - 2026'.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e mësimi jo formal.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kam kërkuar dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, që të na sjell dikush listën e mësimdhënësve që përfitojnë nga kjo pagesë, tek kjo pikë e rendit ditës, por nuk e kanë dërguar. Hap diskutimin.

Fisnik Sllamniku: Kemi pikën e rendit të ditës 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e mësimit jo formal'. Siç e dimë ky mësim nuk zhvillohet në bazë të normave të përcaktuara dhe nxënësve, në moshën e përcaktuar për shkollimin e mesëm, këta që i nënshtrohen mësimit jo formal, janë ata që kanë kaluar moshën mbi 18 vjeçare, që për kushte të ndryshme nuk kanë mundur me majtë mësim të rregullt dhe për këtë arsye duhet, me u paguar këta mësime, të cilët e marrin një shtesë, për arsye se shkollat nuk kanë llogari bankare të veçantë dhe jemi të detyruar me i dërguar në llogarinë komunale dhe komuna t'i shpërndan në bazë të vendimit.

Durim Hajra: Vërejtja jonë është, pse nuk është prezentë askush nga Drejtoria e Arsimit.

Mirsad Qyqalla: Kishte qenë mirë, për arsye të respektit të Kuvendit të Komunës, me qenë dikush prezent, po ashtu dje kemi propozuar që me ardhur lista e mësimeve, jemi për mirëpo duhet me pasur respekt.

Hasan Ismajli: Propozimi për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e mësimit jo formal, është një shumë prej 150€ viti, por mësimeve që mbajnë mësim është normale, se duhet të paguhen, sepse mbahet pas orarit të punës, ato mjete financiare që secili nxënës i paguan në bankë, para se me filluar mësimi, i shkojnë në llogari Drejtorisë së Arsimit e cila pastaj duhet me marrë miratimin e Kuvendit të Komunës, për me u ndarë mjetet financiare, atyre mësimeve dhe personelit administrativ dhe teknik që janë në këtë grup dhe unë jam për.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Unë deshta me folë këtu për arsye, se sikur unë që ja dijë rëndësinë, nuk i'a dinë askush, se vetë kam qenë njëri prej tyre, nxënës i viteve 1992, sepse atëherë nuk kam mundur me kryer mësim të rregullt, sukcesi im tani shihet. Kam një kërkesë, që t'i inkuadrojmë dhe të bëjmë lëshime tek rastet sociale me i liruuar prej pagesës.

Hasan Ismajli: Rastet sociale dhe rastet me nevoja të veçanta i kanë liruuar çdo herë nga këto pagesa për mësimin jo formal.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e mësimit jo formal'.

U votua unanimitisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Nuk merrë pjesë në votim anëtari i Kuvendit të Komunës, profesori z. Jahush Krasniqi për arsye të konfliktit të interesit.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovon 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e mësimit jo formal' dhe mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për 'Rroga dhe paga'.
2. Mjetet financiare në shumë të përgjithshme prej: 25,177.13€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor, mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm dhe shpërndahen për shpenzim si në vijim: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Ekonomike 'Hoxhë Kadri Prishtina', kodi i programit Nr.

94232, shuma 8,107.05€ dhe në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike 'Minatori',
kodi i programit Nr. 94231, shuma 17,070.08€,

Pika e shtatë (7) - Propozim për formimin e Komisioneve për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Sportistëve për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, dua të sqaroj se tek kjo pikë e rendit të ditës, duhet të mirren dy vendime për formimin e Komisioneve, njëri është për Kryesuesin e vitit 2024 dhe tjetri për Sportistët e vitit 2024. Këtu duhet të jenë katër anëtarë të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, dy anëtarë të Ekzekutivit të Komunës dhe një anëtarë nga Shoqëria Civile, ftoi Shefat e Grupeve Parlamentare që të japin propozimet e tyre.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Lidhjes Demokratike e Kosovës, e propozojmë znj. Arbnora Kelmendi për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Kryesuesit për vitin 2024 dhe z. Fidan Berisha për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Sportistëve të vitit 2024.

Doruntina Jashari: Nga Grupi Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje e propozojmë z. Habib Mekolli për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Kryesuesit për vitin 2024 dhe znj. Hasime Kostanica për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Sportistëve të vitit për vitin 2024.

Mirsad Qyqalla: Ne Partia Demokratike e Kosovës, nuk marrim pjesë në Komisionet për Kryesuesin dhe Sportistët për vitin 2024.

Hasan Ismajli: Herën e kaluar kemi qenë të gjithë anëtarët e partive politike, partitë e vogla nga një anëtar, partitë e mëdhaja nga dy anëtarë, unë mendoj se kemi bërë një punë të mirë dhe i kemi shikuar me shumë kujdes Sivi-të e aplikuesve, zgjedhja është bërë e merituar, por dëshpërimi ka qenë në sallë, sepse për ne asamblie të vendi ishte në fund të sallës, ka pasur edhe reagime nga anëtarët e Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Pastaj kur u bë ndarja e shpërblimeve edhe aty u anashkaluam dhe për këtë arsye, unë nuk dua të marrë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në emër të Partisë së Drejtësisë, nuk marrë pjesë në Komisionin për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Sportistëve për vitin 2024.

Laureat Gojnovci: Lidhja Demokratike e Kosovës e propozon për anëtarë edhe z. Etnik Berjani për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Kryesuesit për vitin 2024 dhe z. Bashkim Krasniqi për zgjedhjen e Sportistëve për vitin 2024.

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sportit: Unë po i marrë shumë seriozisht vërejtjet, të cilat i dhanë asamblie të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës. Kërkoj që ditën kur kemi organizimin, të vini të më ndihmoni dhe ta bëni zgjedhjen ku të uleni, aty ku ju dëshironi. Për 'Propozimin për formimin e Komisioneve për zgjedhjen e Kryesuesit, nga Ekzekutivi dhe Administrata e Komunës' e propozojmë znj. Vlora Berjani dhe z. Bajram Rexhepi, ndërsa nga Shoqëria Civile e propozojmë z. Përparim Uka, ndërsa për 'Propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Sportistëve nga Ekzekutivi dhe Administrata e Komunës e propozojmë z. Agron Breznica dhe z. Adnan Bullatovci, ndërsa nga Shoqëria Civile e propozojmë z. Maliq Thaçi

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Kryesuesit për vitin 2024 në përbërje si vijon: Arbnore Kelmendi, Habib Mekolli, Etnik Berjani, Vlora Berjani, Bajram Rexhepi dhe Përparim Uka.

U votua me: njëzet vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovon 'Propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Krijuesit për vitin 2024', në përbërje si vijon: Arbnore Kelmendi, Habib Mekolli, Etnik Berjani, Vlora Berjani, Bajram Rexhepi dhe Përparim Uka dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Krijuesit të vitit 2024', në përbërje prej gjashtë (6) anëtarëve:
 - 1.1 Arbnore Kelmendi - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.2 Habib Mekolli - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.3 Etnik Berjani - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.4 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë për Arsim, anëtare;
 - 1.5 Bajram Rexhepi - Zyrtar për Informim, anëtar dhe
 - 1.6 Përparim Uka - Shoqëria Civile, anëtar.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Sportistëve për vitin 2024 në përbërje si vijon: Fidan Berisha, Hasime Kostanica, Bashkim Krasniqi Agron Breznica, Adnan Bullatovci dhe Maliq Thaçi.

U votua me: njëzet vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovon 'Propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Sportistëve për vitin 2024', në përbërje si vijon: Fidan Berisha, Hasime Kostanica, Bashkim Krasniqi Agron Breznica, Adnan Bullatovci dhe Maliq Thaçi dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Sportistëve të vitit 2024', në përbërje prej gjashtë (6) anëtarëve:
 - 1.1 Fidan Berisha - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.2 Hasime Kostanica - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.3 Bashkim Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.4 Agron Breznica - Zyrtar për Sport, anëtar;
 - 1.5 Adnan Bullatovci - Zyrtar i Lartë për Mjedis, anëtar dhe
 - 1.6 Maliq Thaçi - Shoqëria Civile, anëtar.

Pika e tetë (8) - Propozim për ndryshimin e vendimit Nr. 93, të datës 31.03.2022 për anëtarët e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndryshimin e vendimit Nr. 93, të datës 31.03.2022 për anëtarët e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', kjo çështje është ngritur nga anëtarja e Kuvendit të Komunës znj. Aida Alimi, që është Kryesues e këtij Komisioni. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Ne propozojmë një ndryshim në vend të z. Shpend Bardiqi në këtë komision vjen z. Vlonjat Hasani.

Aida Alimi: Propozoj që në 'Komisionin për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', të jetë edhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit z. Ardit Sekiraça, për arsye se na duhen kërkesat të cilat janë adresuar në këtë drejtori.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po ashtu në këtë Komision 'Komisionin për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', hyn z. Fatlum Berisha - Drejtor i Arsimit dhe z. Ali Topalli - Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: A ka mundësi të jem edhe unë anëtar i Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Jo nuk mundeni për arsye se është znj. Qëndresa Ademi.

Hasan Ismajli: Cili është kriteri për ndryshimin e emrit të rrugës, sepse ka një kohë të gjatë, ku nuk është ndërruar as një emër i rrugës, edhe pse ka shumë kërkesa nga qytetarët. Ne duam ta dimë cili është kriteri?

Aida Alimi: Në pa mundësi të punës së Grupit Punues, nuk kemi pasur mundësi, as kritere me vazhduar tutje dhe përgjigje qytetarëve nuk i'u kemi dhënë ende, me plotësimin e këtij Komisioni tani do të funksionalizohet grupi dhe do të fillojmë punën, sipas kritereve të lejuara të punës vetëm për rrugë të reja.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për ndryshimin e vendimit Nr. 93, të datës 31.03.2022 për anëtarët e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', me anëtarët e rinj: Vlonjat Hasani, Fatlum Berisha dhe Ali Topalli.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për ndryshimin e vendimit Nr. 93, të datës 31.03.2022 për anëtarët e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', me anëtarët e rinj: Vlonjat Hasani, Fatlum Berisha dhe Ali Topalli dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën paragrafi 1.3, 1.6 dhe 1.7 të 'Komisionit për emërtimin rrugëve dhe vendeve tjera publike' në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës si vijon: Vlonjat Hasani - anëtar i Kuvendit të Komunës nga Lëvizja Vetëvendosje, Fatlum Berisha - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Ali Topalli - Drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit, nga pika një (1) e këtij Vendimi është 'Emërtimi i rrugëve të reja, shqyrtimi i ankesave të ndërlidhura me plotësim ndryshimin e emërtimit të rrugëve ekzistuese dhe emërtimin e vendeve tjera publike' në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e nëntë (9) - Propozim për rishqyrtimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 120, të datës 03.10.2024 sipas shkresës 020-619/2 të datës 21.10.2024, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, vendimi është kthyer si i kundërligjshëm, ne e kemi kërkuar një takim zyrtar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, kanë ardhur dhe kemi mbajtur një takim në komunë, ku kam qenë edhe unë prezentë në këtë takim nga pozita e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, ata na kanë informuar, që sa i përket Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronave, në ligjin e vjetër ka ekzistuar një nen ku ka thënë, se ka të drejtë me i'u dhënë për shërbim qytetarëve, po ashtu u cek edhe Bashkësive Fetare dhe me ligjin e ri ai paragraf më nuk ekziston dhe na kanë këshilluar me ndjek këtë formë, qysh ne jemi tu e ndjek, ndryshimplotësimi i vendimit.

Nënkryetari i Komunës: Nuk kam çka me shtuar prej asaj, çka e kam thënë dje tek Komiteti për Politikë dhe Financa, me sa kam parë unë ka qenë përkrahje unanime për këtë pikë dhe me ndarë një lokacion për Xhami, nëse nuk gaboje s'ka pasur kundër. Nëse Komuna ka përfitim publik, për ne mendimi ynë është se interes publik më të madhe se ndërtimi i Xhamisë nuk kemi ne si komunë.

Laureat Gojnovci: Ashtu siç e tha Nënkryetari në thelb është e njëjta dhe sipas udhëzimeve të ministrisë së linjës, i ndjekim këto udhëzime dhe ne jemi për.

Durim Hajra: Dua një sqarim i nderuar Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, a'ka me u shfuqizuar vendimi i parë, të cilin e kemi marrë me Nr. 120, i datës 03.10.2024.

Nënkryetari i Komunës: Asambleisti z. Durim Hajra, ka ngrit një çështje shumë të rëndësishme, të cilën ne e kemi diskutuar, verzionin e parë e kemi pasur mi dërguar dy pika të rendit të ditës, mirëpo pas konsultimit edhe me profesionistë të tjerë, na kanë treguar që nuk ka nevojë, me i dërguar dy pika të rendit të ditës, sepse ne po e shqyrtojmë, vendimin i cili është marrë në Kuvendin e Komunës dhe është kthyer në rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në atë pikë të rendit të ditës, bëhen ndryshimet adekuate, në bazë të këshillave dhe sugjerimeve të cilat na i kanë dhënë Ministria, ne ndryshojmë vendimin, të cilin e kemi marrë në Kuvendin e Komunës me datë 26.09.2024 dhe e ndryshojmë për pikën kontestuese, të cilën e ka kthyer Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Migjen Kolshi: Ne si Parti Demokratike e Kosovës, e kemi përkrah këtë vendim dhe jemi për ndërtimin e Xhamisë, mirëpo edhe Ekzekutivi i Komunës e dinë që ky vendim nuk kalon, ky propozim ka ardhur, për larjen e borxheve të cilin Kryetari i Komunës, u'a ka dhënë Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, ku ju ka premtuar një ngastër kadastrale për ndërtimin e Xhamisë. Kam informacion edhe nga Ministria, e cila më ka thënë që nuk kalon, është ndërrim i pronës por barrën ju u'a dërgoni Kuvendit të Komunës, sepse po dëshironi ta largoni nga vetja.

Hasan Ismajli: Jeni duke e shkelur ligjin, Kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Bashkësinë Islame të Kosovës, jeni duke e qitur në një pozitë të pa lakmueshme, unë nuk jam asnjëherë kundër ndërtimit të Xhamisë, por kam dëshirë kur të votoi, mos të kthehet nga Ministria e linjës, sepse jashtëligjshëm jemi duke punuar, shikoni çka na servon neve drejtoria e caktuar, unë nuk e di kjo, a është fletë poseduese, a çka, sepse duket si fletë poseduese e nuk është, këta

kanë bërë kërkesë për parcelizim të 27.40 metra të asaj ngastre kadastrale në Bresje dhe kanë bërë kërkesë për parcelizimin e kanë bërë 3-4 vite më herët, e keni në grafikë, u'a kam treguar. Kjo ngastër kadastrale, e cila është e dedikuar me 18 ari, tani me 1800 meter katror për me u ndërtuar Xhamia dhe ka një numër të veçantë dhe kjo është ndarë prej kësaj ngastre kadastrale, sipas fletës poseduese janë në total 27.40 ari, dy ari e katër dhjetë metra atje janë avulluar, unë e kam theksuar edhe në mbledhjen e kaluar, ku ju kam thënë hulumtoni dhe nëse unë e kam gabim nuk do të rri më këtu, sepse kjo i'u është dhënë një privati aty dhe mbas privatit 2 ari e 40 metra, janë edhe gjashtë ari e 80 metra, pronë e komunës, deri tek shtëpia të cilit ju ka ndërtuar me ndihma, që është pronë komunale dhe kur e komplet, komplet aty dalin 27 ari, por këtu u nda grafika dhe na servojne neve këtu. Këtu thotë urdhërohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë të bëjë ndarjen dhe kur kanë me bërë dhe kush e bënë, këtu duhet me u angazhuar një kompani private një gjeodet privat i licencuar, që e bënë këtë, ndërsa këta e bëjnë ashtu siç e kanë bërë tek tregu dhe kjo është e kundërligjshme, ne duke mos u angazhuar me marrë këso lloj letra, ata na i kthejnë mbrapa, unë e kam këtu Komunën e Gjakovës, e cila ka Kishë Katolike, ka edhe Xhami, por edhe Tyrbe aty, pra janë të gjitha, i kanë me Hartë Zonale të Komunës dhe kur i dërgon në Kuvendin e Komunës, fletën poseduese e ka me vulë, ndërsa neve na servohet pa vula dokumentacioni, kjo pa vul mendoj se është falls, nuk vlen asgjë, sepse askush nuk guxon aty brenda me nënshkruar dhe me vulosur, sepse është falsifikim. Ne atë pjesë me Hartën Zonale të Komunës, e kemi të paraparë për shkollë. Nëse atë ngastër kadastrale i'a kemi premtuar Myftiut të Kosovës, me i'a dhënë, jepeni, por jepeni ligjërisht, futeni në Planin Zhvillimor Komunal, kryen Planin Zhvillimor Komunal, dërgone në diskutim publik dhe silleni në Kuvendin e Komunës, bëjëni ndryshimin në Hartën Zonale të Komunës, në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal, sepse ne asnjëherë nuk jemi kundër xhamisë, por ligjërisht duam me qenë në rregull, kjo do kthehet mbrapa ashtu siç e theksoi asambleisti z. Mijgen Kolshi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ministria kur e ka kthyer Vendimin, nuk ka thënë që keni dokumentacion falls, sepse i gjithë ky material ka shkruar edhe në Ministri, por Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka shkruar që është në kundërshtim me nenin 5, pika 1.3 e ligjit. Neni 5 thotë: kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, pika 1.3 thekson se duhet të ketë arsyeshmëri dhe interes publik apo përfitim ekonomik të komunës, unë nuk di që ka interes më të madh publik, sesa Xhamia në Fushë-Kosovë, sepse ne falemi jashtë në shi e në borë në mungesë të hapësirës, të gjithë kemi votuar për t'i krijuar kushtet, ne jemi takuar shumë herë me Myftiun e Kosovës z. Naim Tërnavë dhe përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame, gjatë takimeve që unë kam marrë pjesë nuk kam dëgjuar që kemi borxh ndaj Myftiut, kemi borxh ndaj qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës, e cila është kërkesë e kahmotshme. Ideja është si me gjetur metodën, i kemi ftuar zyrtarët e Ministrisë, ata na kanë rekomanduar në këtë mënyrë me vepruar, edhe pse nuk na kanë dhënë garancion, se nuk kanë me kthyer këtë vendim, e jona është me rishikuar dhe nëse e kthejnë prapë këtë vendim, ne do të mundohemi prapë me gjetur një mënyrë, vetëm e vetëm për me u'a lehtësuar qytetarëve kërkesën e tyre.

Hasan Ismajli: Çdo dokument i cili vjen në Kuvendin e Komunës, i pa nënshkruar dhe i pa vulosur nuk ka vlerë, ju po e bini rendin e ditës që s'ka vlerë, sepse ju po e vulosni dhe po e nënshkruani, një ngastër kadastrale që kushton me mijëra euro, e cila na prezantohet blanko.

Artan Asllani: Unë nuk jam kundër Xhamisë dhe ime, do jetë për, Nënkrjetari i Komunës tha se duhet me u legalizuar, kemi edhe disa Xhami të cilat janë në Komunën e Fushë-Kosovës, sikur është Xhamia në lagjen 028 dhe 029 në Fushë-Kosovë dhe ajo Xhami prej Bashkësisë Islame të Kosovës, nuk shihet si objekt fetar dhe fatëkeqësishtë është e lërë anash, kjo me shtyri mua më shumë Kryesues i Kuvendit të Komunës me dalë në foltore, kur dëgjova që jeni takuar dhjetëra herë me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe ndoshta kishte qenë mirë me u'a dërguar një mesazh, që është një Xhami në lagjen 028 dhe 029, që kryesisht 99% të xhematit të asaj bashkësie janë të komunitetit dhe fatkeqësisht Bashkësia Islame e Kosovës, ka lënë anash këtë Xhami, sepse imani vjen vetëm të premtëve dhe vjen dy minuta përpara. Nëse keni mbajtur takime kishte qenë mirë me u cek edhe kjo çështje.

Mirsad Qyqalla: Në kërkesën e Bashkësisë Islame të Kosovës, nga Kryetari i Komunës është marrë një zotim me ua dhënë një pronë, aty po shkruan që Drejtoria e Planifikimit Urban e ka gjetur një hapësirë, ne e kemi mbështetur dhe barra e përgjegjësia mbetet mbi ta, ne kemi vendosur me ua dhënë edhe një mundësi dhe ta shtyenë përpara, për problematikat të cilat i tha kolegu, ne e dimë se shumica qëndrojnë, ju e keni dërguar për një ndryshim, ne jemi për, por nëse kthehet prapa nuk e di si do veproni.

Hasan Ismajli: Ky vendim, a shkon prapë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, apo shkon në ndonjë Ministri tjetër. Meqenëse ju keni biseduar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Nënkrjetari i Komunës: Ne nuk po dojm me ndarë tokë për Xhami, por kemi ardhur sa për sy e faqe dhe po e gjejmë një variant si me shtyer përpara dhe si mos me penguar këtë proces, ky nuk është një zotim i Kryetarit të Komunës, fare hiq mund të jetë një zotim i imi si Nënkrjetar i Komunës, çështjen e pronës e ka rregulluar ligji dhe për çështjen e pronës është autoritet Kuvendi i Komunës, po të ishte Kryetari i Komunës nuk kishim diskutuar sot këtu dhe ndoshta tani ishte duke u ndërtuar Xhamia ose do kishim marrë një përgjigje negative. Ne për këtë tokë dhe për këtë Xham, nuk po ua japim Bashkësisë Islame, por po ua dedikojmë qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës, ne kemi ardhur me këtë diskutim sot për herën e dytë këtu, por nëse ka një propozim tjetër, për një variant tjetër me kryer këtë punë, që ju e dini, që nuk e kthen Ministria e kemi pikën e rendit të ditës dhe me sa kuptojë unë nuk është e ndaluar, mund të ketë një propozim tjetër, që mos të quhet vendim për caktimin e lokacionit, të quhet një vendim tjetër, një variantë tjetër, që merr shumicën e votave këtu, të këtij Kuvendi të Komunës, edhe merr një vendim, unë dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kemi qenë borgjlinj të këtij kuvendi, me bërë një konsultim dhe me pruar ashtu siç e kemi marrë një këshillë, personalisht, kur e kanë kthyer kam menduar që po dojm autoritetet diçka tjetër, që ndoshta me bë një komision, me bërë një shpallje publike, ndoshta dikush duhet me aplikuar, përgjigjja ka qenë jo, nuk ka nevojë, por ka nevojë me arsyetuar interesin publik dhe ne e diskutuam se ky është interes publik. Pyetet ku ka me shkuar ky vendim në rishqyrtim, me ligjin ekzistues duhet mi drejtuar tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

por nëse është tokë pyjore, shkon edhe në Ministrinë Bujqësisë Pyltariisë dhe Zhvillimit Rural, nëse don me qenë në harmonizim me Planin Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale të Komunës, shkon edhe tek Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, po dua me qenë shumë i qartë, askush e as më pak unë, mundem me thënë, se çka ka me kthyer ministria pas këtij vendimi. Nëse ky verzion nuk është i plotë ju lutem juve anëtarë të Kuvendit të Komunës përgatitni propozimin dhe po e ndërrojmë si pikë të rendit të ditës. Nëse ne marrim vendim sot për caktimin e lokacionit, nëse 30 ditë ministria e linjës nuk e kthen, ose e kthen që është mirë, cili është hapi i radhës, hapi i radhës do të jetë që Bashkësia Islame e Kosovës si bartëse e projektit, ka me ardhur në komunë tek Drejtoria e Planifikimit Urban për leje ndërtimore, a ka me mundur pastaj Drejtoria me lëshuar leje për ndërtim të Xhamisë, me vendimin e Kuvendit të Komunës për lokacionin e Xhamisë. Nëse keni ide ju lutem na sqaroni.

Hasan Ismajli: Unë ju garantoj, që nëse ka zyrtar këtu që mundet me lëshuar leje, përveç këtij këtu, nuk është imediate ajo Xhami me u nis nesër, hajde ne 27 anëtarët të bëjmë një punë të mirë dhe propozimin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e fusim në Planin Zhvillimor Komunal, vjen votohet Harta Zonale e Komunës dhe zonë i dedikohet Xhamisë, atëherë s'ka presion askush.

Vlonjat Hasani: Në bazë të asaj që tha Nënkryetari, që ministria ju kanë kërkuar arsyetim Propozim bashkangjijtjv një peticion, kërkesë të drejtpërdrejt të qytetarve mendoj se e bënë më të fuqishme kërkesën për xhami atë pjesë.

Nënkryetari i Komunës: Ka qenë kërkesë e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit lokal, me i'a garantuar interesin publik, herën e parë kur e kemi pruar këtë kërkesë, e kemi ditur normën e kemi ditur edhe nenin 5, ky nen i ka tri çështje që ngarthen mes veti, procedurën, përmbajtjen dhe kriterin, kriteri ka qenë interesi publik, procedura ka qenë me u miratuar Kuvendi i Komunës dhe përmbajtja ka qenë toka.

Pas sqarimeve tjera Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 120, të datës 03.10.2024, mbështetur në shkresën zyrtare 020-619/2, të datës 21.10.2024 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal', përmes të cilit bëhet caktimi i lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në ngastrën kadastrale Nr. P-72514036-01375-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 14-942-25512, të datës 19.08.2024.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në procesin e votimit vlenë të sqarohet se nuk mori pjesë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, duke u mbështetur në punën me honorar që e bënë si imam në një fshat të komunës dhe mbështetur në dispozitat e nenit 38 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovon 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 120, të datës 03.10.2024, mbështetur në shkresën zyrtare 020-619/2, të datës 21.10.2024 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal', përmes të cilit bëhet caktimi i lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në ngastrën kadastrale Nr. P-72514036-01375-0, në Zonën

Kadastrale Fushë-Kosovë, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 14-942-25512, të datës 19.08.2024 dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 2096, të datës 15.11.2024, për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 120, të datës 03.10.2024, sipas shkresës zyrtare 020-619/2, të datës 21.10.2024 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në paragrafin një si vijon: caktohet lokacioni me destinim për ndërtimin e objektit të Xhamisë në Fushë-Kosovë, në ngastrën kadastrale Nr. P-72514036-01375-0, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 14-942-25512, të datës 19.08.2024, në sipërfaqe S =1800m².
2. Paragrafët dy, tre dhe katër të vendimit të rishqyrtuar fshihen, paragrafi pesë ndryshohet me caktimin e obligimeve të Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës për kryerjen e matjeve gjeodezike dhe skicimin e pronës së caktuar si lokacion për ndërtimin e Xhamisë të evidentuar në paragrafin një të këtij vendimi.

Pika e dhjetë (10) - Rishqyrtimi i vendimit Nr. 94, të datës 08.07.2024, sipas shkresës 020-464/4 të datës 08.08.2024, për lejimin e mjeteve financiare dhe hapjen e procedurave për norma - vende të reja të punës në arsim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi marrë një vendim dhe ky vendim nuk është kthyer një kohë të gjatë, e kemi publikuar në ueb-faqen e komunës, janë paguar mësimdhënësit dhe në tetor e kanë kthyer, më kanë thirrë në telefon, pse nuk e keni shfuqizuar, pastaj unë ju kam drejtuar me email që nuk është kthyer asgjë, pastaj e kanë kthyer.

Laureta Gojnovci: Kryesues i Kuvendit të Komunës, unë ju kuptoi, nga ana e pozitës së cilës e mbani, është në drejtën tuaj, por ky vendim është publikuar, sepse ka kaluar afati ligjor prej 30 ditëve dhe nuk e shohim të arsyeshëm me marrë pjesë në këtë vendim.

Durim Hajra: Atë se çka e tha z. Laureat Gojnovci, është shumë e çuditshme, nëse Ministria e ka kthyer, që është në kundërshtim me ligjin, nuk ka të bëjë asgjë, a është publikuar apo jo, duhet me gjetur forma tjera, ne jemi për me shfuqizuar këtë vendim me qenë se është i kundërligjshëm.

Mirsad Qyqalla: Ne i pamë vërejtjet që i ka dhënë ministria, por ne abstenojmë, sepse e ka kaluar afatin ligjor dhe ministria s'ka kthyer përgjigje.

Hasan Ismajli: Nëse ministria e ka kthyer, me vonesë përgjigjen, atëherë për mos punën e tyre ne me shfuqizuar, s'po më duket në rregull, sepse neve po na mbesin mësimdhënësit pa paguar dhe dëmin e barrën e marrim ne. Ndërsa nëse është kthyer me kohë dhe nuk ka ardhur me u shfuqizuar nuk është në rregull, sepse ne e kemi pasur edhe një rast të tillë me Hartën Zonale të Komunës.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për shfuqizimi vendimit Nr. 94, të datës 08.07.2024, sipas shkresës 020-464/4 të datës 08.08.2024, për lejimin e mjeteve financiare dhe hapjen e procedurave për norma - vende të reja të punës në arsim' U votua me: katër vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej katër anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me mungesë të votave nuk e aprovon 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit Nr. 94, të datës 08.07.2024, sipas shkresës 020-464/4 të datës 08.08.2024, për lejimin e mjeteve financiare dhe hapjen e procedurave për norma - vende të reja të punës në arsim'

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Informatë e Drejtorisë së Planifikimit Urban lidhur me Projekt-Planin Zhvillimor Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në formën e shkruar 'Informatën e Drejtorisë së Planifikimit Urban lidhur me Projekt-Planin Zhvillimor Komunal', ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban të na jap sqarime tjera.

Drejtori i Planifikim Urban: Po ju informoj se me hartimin e 'Planin Zhvillimor Komunal', kemi mbërrirë në fazën përfundimtare, kemi respektuar të gjitha procedurat sipas udhëzimit administrativ, për hartimin e planeve hapësinorë, duke përfshirë diskutimet me publikun, në formimin e grupeve punuese sektoriale, duke pasur parasysh se ky plan është strategjikisht plani më i rëndësishëm, multi sektorial për komunën, me datën 08-09.11.2024, kemi mbajtur një punëtori me qëllim të përshpejtimit të punës, me fokus të veçantë, pjesën hartografike, qëllimi i kësaj punëtorie ka qenë që, të përcaktohen zhvillimet edhe qasjet zhvillimore për Komunën e Fushë-Kosovës, për dhjetë vitet e ardhshme, duke pasur parasysh, se fazën për të cilën ne po e humbim në hartim të Planit Zhvillimor, po supozojmë se edhe pasi i skadon afati shkon dy vite, ky plan është në fuqi deri në vitin 2032 tetë vite. Kompania konsulente 'INSI', si pika ma e rëndësishme e kësaj informate, unë po ndalem tek çështja më e rëndësishme kadastrale në Fushë-Kosovë. Zona e cila ka mbetur e pa trajtuar me planin aktual, Hartat Zonale Komunale, në takimet e mbajtura, qëllimi jonë ka qenë me komunat fqinje, posaqërisht me Komunën e Graçanicës, sepse e kemi quajtur si zonë kontestuese, ka qenë me rëndësi që të përcaktohem, se kush do ta trajton këtë zonë, në aspektin e zhvillimit hapësinorë, a do të jetë Komuna e Graçanicës apo e Fushë-Kosovës, duke marrë parasysh të gjitha argumentet si planet hapësinore paraprake, si shërbimet të cilat qytetarët, e kësaj zone i marrin në Komunën e Fushë-Kosovës edhe Komuna e Graçanicës e ka konfirmuar se, që në procedurën e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të saj, ata nuk e kanë futur si pjesë në planin e vetë dhe përfundimisht me ndryshimin e kufirit të zonës kadastrale, edhe nga Agjensioni Kadastral i Kosovës, tani është e vërtetueshme për të gjitha palët e interesit, këtë mundemi me vërtetuar edhe në Gjeo-Portal Kosova, ka ndodh një korrigjim i zonës kadastrale në Fushë-Kosovë, unë i kam bashkangjitur edhe pjesën hartografike për me mundur ju me krahasuar, gjendjen paraprake dhe gjendjen e tanishme, po ashtu në pjesën e fundit e kam bashkangjitur, edhe Planin Zhvillimor Komunal aktual, ai i cili është në fuqi, i cili e ka pasur këtë zonë brenda trajtimit, me të cilin plan zhvillimor urban janë lëshuar edhe lejet ndërtimore, të banimit kolektiv në atë zonë, çka ka ndodh në dis favor të banorëve të asaj zone është se në vitin 2020-2021, me Hartën Zonale të Komunës, kjo zonë ka mbetur jashtë planifikimit, me arsyetimin se kufiri kadastral, nuk është aty, ku po del gjendja kadastrale sipas kadastrit, po sipas një kufiri të Agjencionit Kadastral të Kosovës, për ne kjo punë ka qenë absurde, së fundmi kam bërë një kërkesë, tek Kompania konsulentë 'INSI', duke ofruar argumente shtesë, që në aspektin juridik edhe ata me pasur siguri

dhe mbështetje nga ne si institucion, që nuk janë duke bërë shkelje gjatë hartimit. Kërkesën paraprake e kam dorëzuar në muajin korrik, me të cilën kemi kërkuar me siguar vazhdimësinë e zhvillimeve në procesin hapësinor, ky parim i vazhdimësisë ju ofron atyre qytetarëve që të trajtohen barabartë me qytetarët e tjerë, propozimet të cilat kanë ndodh, të pasqyrohen në Planin Zhvillimor Komunal, atë punë Grupi Punues e ka trajtuar prej fillimi, të gjitha objektet publike, të cilat janë ndërtuar, duke fituar pronë prej investitorit, të cilët kanë investuar në banim kolektiv, së pari toka ka kaluar në pronësi komunale dhe janë ndërtuar objektet, këto ndryshime janë pasqyruar në Planin Zhvillimor Komunal dhe ato janë: Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare tek 'Kompleksi 300', shkolla tek 'Kompleksi 300', shkolla në rrugën 'Amir Elmazi', shkolla tek objektet e 'Al Trade', shkolla e cila po ndërtohet tani tek rruga 'Shukri Obërtinca', Qendra e Mjekësisë Familjare tek rruga 'Vlora' dhe një çerdhe këtu, edhe propozimi për ngastrën kadastrale të Xhamisë atje është zonë e shërbimeve, ajo do mbetet prapë zonë e shërbimeve, vetëm nën - kodi do të ndryshojë me Hartë Zonale të Komunës, sepse destinimi ZSH, prap do mbetet i njëjti edhe në Planin Zhvillimor Komunal, ndryshime të tjera kanë qenë, ndërtimi i impiantit i cili paraprakisht me Planin Zhvillimor Komunal dhe me hartë zonale ka qenë te livadhet e Bresjes, tani është në Lismir, gjitha këto ndryshime do të pasqyrohen në Planin Zhvillimor Komunal, mirëpo mendoj që nuk mundet me pritë, që zhvillimet me u stopuar, deri sa të aprovohet Plani Zhvillimor Komunal, ne mendojmë se ka qenë e mundshme me vazhduar tutje, tani ato pasqyrime veç kanë ndodh, për këtë çështje u mbajt takimi i 08-09.11.2024, pjesën hartografike që ka të bëjë, me ndryshimet e destinimit, përcaktimi final për hartografinë të cilën shumë shpejtë do të shfaqet në korridorin e komunës, për shqyrtim publik tridhjetë ditë, aty mundemi me pasur debat, posaçërisht me Kuvendin e Komunës mundemi me organizuar një datë ku mundet me qenë prezent edhe kompania, për me bërë një prezantim, në mënyrë që kur të vjen për votim, mos të kemi paqartësi dhe procesi të shkoj më shpejtë, duke pasur parasysh që volumi i dokumentit është shumë i madh, unë nuk e kam bashkangjitur sot këtu projektin, sepse pjesa tekstuale është afërsisht 400 faqe dhe me printuar për secilin, më është dukur e panevojshme, është i qasshëm në ueb-faqe, linku i Planit Zhvillimor Komunal, ajo është bërë me qëllim që qytetarët të mundën me dhënë komente, edhe online, pa pasur nevojë me bërë kërkesë me shkrim. Ne thuaj se kemi mbërrirë në projektin final, shpejt do të hapet shqyrtimi publik dhe aty do kemi mundësinë me i shqyrtuar të gjitha zhvillimet dhe ndryshimet në aspektin hapësinorë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë ju kisha lutur që me pas një takim informues me anëtarët e Kuvendit të Komunës, që kur të vijë si pikë e rendit ditës mos me marrë kohë.

Mirsad Qyqalla: Unë kam dy pyetje për Drejtorin e Planifikimit Urban, ndryshimi i Hartës Zonale të Komunës prej Agjensisë Kadastrale të Kosovës, nuk paraqet ndonjë problem, kemi të drejtë, nuk bëjmë shkelje, sepse është kohë e gjatë që debatohet për atë zonë, ku tani ka kaluar me Fushë-Kosovën, por dua të pyes me këtë Plan Zhvillimor Komunal, a arsyetohen bonuset e zonimit, në emër të Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe shkollës.

Drejtori i Planifikimit Urban: Mundeni me përcjell pjesën grafike që e keni të bashkangjitur. Ky është kufiri i Komunës së Fushë-Kosovës, një pjesë e zonës urbane dhe kjo është marrë prej Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës, konkretisht Zona Kadastrale Fushë-Kosovë, nëse

kjo është Zonë Kadastrale Fushë-Kosovë, për mua nuk ka pasur argument, që kompania kur e ka marrë në atë kohë, e ka projektuar Hartën Zonale të Komunës si plan hapësinor, duke përjashtuar atë zonë, sepse nëse është Zonë Kadastrale e Fushë-Kosovës, nëse po punohet mbi këto vija, atëherë e kemi edhe një fletë përpara, pse ajo nuk e ka një ngjyrë aty, ishte dashur me pasur një ngjyrë, në këtë raste të portokalltë, njëjtë sikur zonat e banimit të cilat janë në fqinjësi, me pasur vazhdimësinë e trajtimit, ky është argument pse nuk përbën shkelje.

Mirsad Qyqalla: Një nën pyetje, meqë është kompani e njëjtë, që e ka bërë edhe Planin Zhvillimor Komunal, edhe Hartën Zonale të Komunës, cila ka qenë përgjigjja kur është bërë harta zonale, që nuk është përfshirë ajo pjesë.

Drejtori i Planifikim Urban: Përgjigjja ka qenë, se kufiri kadastral ka qenë deri aty ku e kanë projektuar ata, mirëpo tani me përmirësimin e kufijve kadastral, edhe një argument më shumë është për Komunën e Fushë-Kosovës, e një argument më pak për kompaninë, sepse nëse ju hyni në gjeo-portal, pronat e juaja janë jashtë kufirit të zonës kadastrale, ajo ka krijuar një pasiguri juridike, për të gjithë zyrtarët e urbanizmit, për me avancuar tutje me zhvillimet që kanë ndodh deri në vitin 2021, pse u ndalem në vitin 2021, është se Harta Zonale e Komunës, nuk është mbështet në zhvillimet që palët i kanë kërkuar, përndryshe, në kërkesën e muajit korrik, unë e kam shkruar edhe një paragraf që palët të cilat ne i kemi refuzuar, ata individualisht kanë shkruar në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe për atë i kanë marrë disa përgjigje, që deri dikun ua kanë dhënë të drejtën, që ne me i trajtuar dhe decidivisht thuhet se obligohet Drejtoria e Planifikim Urban, që të nxjerrë akte administrative, por prapë se prapë s'ka qenë sqarim juridikisht i pranueshëm për ne, sepse Akti Administrativ mundet me qenë një vendim që brenda për brenda mundet edhe me refuzuar palën në kërkesën e tij, mirëpo me ndryshimin e kufirit kadastral, po besojmë që jemi në rregull. Tek bonueset e kam sqaruar edhe në të kaluarën, për interes të përgjithshëm publik, i kemi pasur disa aktivitete të listuara, duke filluar nga institucionet shkollore, çerdhe, institucionet e mjekësisë, por tek bonuset nuk mundemi saktë me përcaktuar lokacionin, sepse nuk e dimë se ku mundet me ardhur në shprehje, ne nuk e dimë cili ka me qenë investitori i radhës, i cili ka me investuar në hapësirat në sipërfaqe të mëdhaja, e të cilave ne edhe nëse ua heqim 20-30 ari, nuk e pamundëson zhvillimin, e projektit të investitorit, ne nuk mundemi tani me para përcaktuar, sepse nëse ne e para caktojmë realisht, i'a qesim një bllokadë vetit dhe vjen deri tek një pa mundësi për marrëveshje.

Hasan Ismajli: Dua të më sqarosh, kush e ka bërë ndryshimin për kufijtë administrativ, ju dy komunat mes veti apo qeveria përkatëse.

Drejtori i Planifikim Urban: Ndryshimin e Zonës Kadastrale të Fushë-Kosovës, e ka përmirësuar Agjensionin Kadastral i Kosovës, kështu siç po shihet në këtë material dhe realisht këtu është kufiri i Fushë-Kosovës.

Hasan Ismajli: Kufiri Administrativ, nuk ka drejtë me u ndërruar mes dy komunave, mandatin e kaluar është votuar dhe është shfuqizuar urgjentisht kjo. Te shikojmë, a po e ndryshon pas një kohe Komuna e Graçanicës apo e lenë ashtu siç është. Unë kam thënë Plani Zhvillimor Komunal, është Kushtetutë për Komunën dhe nuk duhet kaluar ashtu siç po mendojmë ne. Ne duhet me u informuar dhe me ditë çka ka, sepse kjo do del edhe në diskutim publik tridhjetë ditë. Keri bërë ndryshimin

të vijës kadastrale dhe pyes, a do të ndërrohen adresat, pasi që Agjensioni Kadastral i Kosovës, sipas jush e ka bërë ndryshimin, apo do jetë me emrin të cilin e ka sot. Ku janë paraparë varrezat në qytet, a keni diskutuar sepse para disa dite, keni qenë me një punëtor, së bashku me INSI-n dhe çka keni diskutuar, cilat kanë qenë kërkesat për varrezat, sepse është fundi i vitit dhe s'ka vend më. Ne kur kemi qenë e kemi pasur një mbledhje, për pjesën e Xhamisë dhe a keni menduar që atë ngastër kadastrale, me i thënë INSI-të, është e nevojshme me u ndërtuar një Xhami, sepse ka nevojë dhe këtë pjesë parashihet të jetë pjesë për atë Xhami, në atë punëtor dy ditore, me vonesë INSI i ka marr pronat nga Drejtoria e Kadastrit Gjeodezisë dhe Pronës, dua ta dijtë sa ka mbetur sipërfaqe tokë bujqësorë dhe çka parashihet në pjesën e fshatit Miradi e Epërme.

Drejtori i Planifikim Urban: Sistemin e adresave duhet me intervenuar niveli qendror, dy zyrtar tani janë prezent në Komunën e Fushë-Kosovës, çështja e varrezave është diskutuar, zgjerimi i lokacionit tek pronat e KEK-ut, këto ndryshime mundeni me i parë në pjesën hartografike të gjitha. Prej muajit korrik jemi duke e pritur një koment prej institucioneve qendrore, por nuk e kemi marrë ende.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për plotësimin e vendimit me Nr. 88 të datës 25.06.2024 për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në Institucionet Edukative Arsimore
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi 'Propozimin për plotësimin e vendimit me Nr. 88 të datës 25.06.2024 për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në Institucionet Edukative Arsimore', të paraqitur për shqyrtim dhe aprovim nga Drejtoria e Arsimit, kjo procedurë për neve është e njohur dhe definuar me udhëzim administrativ. Hap diskutimin.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit me Nr. 88 të datës 25.06.2024 për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në Institucionet Edukative Arsimore'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit me Nr. 88 të datës 25.06.2024 për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në Institucionet Edukative Arsimore' dhe mori:

V E N D I M

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës Drejtorëve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' dhe Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' - Aneksi 1 në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë në Drejtorinë e Arsimit - Kryetare e Komisionit;
 - 1.2 Gëzim Berisha - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Laura Scoti', në Graboc i Poshtëm;
 - 1.3 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit
 - 1.4 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 1.5 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.


Pika e trembëdhjetë (13) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani jemi në pikën 'Të ndryshme', ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 16:40 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

